



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 19363 Prot.

Tiranë, më 25 . 11 .2025

U R D H Ë R

Nr. 2285 datë 25 , 11 .2025

P Ë R

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË INSTITUCIONIT TË
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE KAVAJË, INSTITUCION PËR TË
DËNUARIT E MITUR DHE TË RINJVE TË DËNUAR ME BURGIM DHE TË
PARABURGOSUR**

Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë
Drejtore në DPB dhe drejtore të IEVP-ve

Bazuar në ligjin nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Ligjin Nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitareve dhe bashkëpunëtoreve të drejtësisë”, nenit 112 të VKM Nr.209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Urdhrit Nr.624, datë 16.12.2024 të Ministrit të Drejtësisë, “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, me qëllim përcaktimin e organizimit, disiplinës së brendshme dhe rregullave të detajuara të trajtimit të të dënuarve të mitur dhe të rinjve të dënuar me burgim dhe të paraburgosur, me propozim të Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë,

URDHËROJ

1. Miratimin e Rregullores së brendshme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtori i IEVP Kavajë për zbatimin e këtij urdhri.

3. Drejtoritë e IEVP-ve të organizojnë punën me punonjësit për njohjen dhe zbatimin e rregullores, si dhe informimin e të dënuarve.
4. Rregullorja e brendshme e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë, e miratuar me Urdhër Nr. Nr.5599/2, datë 18.08.2010, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KLEVIS QOSE



RREGULLORE E BRENDSHME
E
INSITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE KAVAJË

KAPITULLI I
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton mënyrën e organizimit, detyrat funksionale të strukturave përgjegjëse, disiplinën e brendshme, rregullat lidhur me trajtimin në kushtet e institucionit, të drejtat, detyrimet dhe mënyrën e trajtimit, regjimit dhe sjelljen e të mitur dhe të rinjve të dënuar me burgim dhe të paraburgosur në Institucionin e Ekzekutimeve Penale Kavajë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë zbatimin efektiv dhe të drejtë të dispozitave të ligjit Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Nenit 25 e në vijim të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Ligjit Nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.209, datë 06.04.2022, “Për miratimin e rregullores të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”, Urdhërit Nr.702, datë 29.12.2022 të Ministrit të Drejtësisë mbi ndryshimin e klasifikimit të IEVP Kavajë si dhe Urdhërit Nr. 624, datë 16.12.2024 të Ministrit të Drejtësisë, “Mbi klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, rehabilitimin social, individualizimin e trajtimit dhe parimin e ligjshmërisë në zbatimin e masave dhe trajtimit të të miturve dhe të rinjve.

Neni 3

Përkufizimet

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. IEVP është Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë.
2. I burgosur është personi i dënuar me burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë si dhe personi ndaj të cilit është marrë nga gjykata masa e sigurimit “arrest me burg”.
3. “I mitur” është çdo person nën moshën 18 vjeç
4. “I mitur në konflikt me ligjin” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.
5. “I ri” është çdo person nga mosha 18 deri në 21 vjeç që akuzohet për kryerjen e një veprë penale, kur ka qenë i mitur.

6. “Interes më i lartë i fëmijës” nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.
7. “Përfaqësues ligjor” është prindi, i afërmi ose kujdestari i të miturit, i cili merr pjesë në procedurën e drejtësisë penale për të mitur për të mbrojtur interesat e të miturit.

Neni 4

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet në Institucionin e Ekzekutimeve Penale Kavajë dhe përfshin:

- a) Të miturit dhe të rinj meshkuj të paraburgosur ose të dënuar me burgim;
- b) Stafin e institucionit, duke përcaktuar detyrimet, përgjegjësitë dhe sjelljen e tyre profesionale.
- c) Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen për të gjithë të miturit dhe të rinjtë, shtetas shqiptarë, shtetas të huaj apo persona pa shtetësi.

Neni 5

Trajtimi i veçantë dhe i përligjur i të miturve dhe të rinjve

1. Trajtimi dhe mbështetja ndaj të miturve, të rinjve, shtetasve të huaj dhe personave të pambrojtur janë të përligjura dhe nuk konsiderohen trajtim preferencial, por një masë e nevojshme për të garantuar barazinë dhe mbrojtjen e veçantë të kategorive vulnerabël.
2. Staf i vendos masat e sigurisë në përputhje me ligjin, duke vlerësuar dhe klasifikuar rrezikun e çdo të mituri dhe të riu, në mënyrë që të sigurohet një ambient i sigurt, ku parandalohen situatat që mund të çojnë në dhunë ose shkelje të rendit dhe sigurisë brenda institucionit.
3. Masat e sigurisë duhet të jenë proporcionale dhe të individualizuara sipas nevojave dhe rrezikshmërisë, duke respektuar parimet e rehabilitimit dhe riintegritit social.
4. Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat përballen të miturit/rinjtë në institucion gjatë transferimit dhe pas lirim.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI DHE DETYRAT E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE

Neni 6

Organizimi

1. Institucioni i Ekzekutimit të vendimeve Penale Kavajë është degë territoriale e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB). DPB është përgjegjëse për zbatimin e politikave, procedurave lidhur me vendosjen, rishpërndarjen dhe menaxhimin e të miturve dhe të rinjve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë.

2. Strukturat përbërëse të IEVP Kavajë janë:

- a) Drejtori;
 - b) Sektori Ligjor;
 - c) Sektori i Çështjeve Shoqërore;
 - d) Sektori i Financës dhe Buxhetit;
 - e) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve;
 - f) Sektori i Kujdesit të Çështjeve Shëndetësore;
 - g) Sektori i Policisë;
3. Detyrat për funksionet e secilit sektor dhe punonjës, zbatohen sipas udhëzimeve të përcaktuara nga DPBurgjeve mbi përshkrimet e punës sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

KAPITULLI III

KRITERET E VENDOSJES SË TË DËNUARVE SIPAS VLERËSIMIT TË SIGURISË NË IEVP

Neni 7

Vendosja në institucion e të miturve dhe të rinjve

1. Vendosja e të miturve dhe të rinjve në I.E.V.P. Kavajë bëhet në mbështetje të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur Nr. 37/2017, Ligjit Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", Urdhërit Nr.702, datë 29.12.2022 të Ministrit të Drejtësisë mbi ndryshimin e klasifikimit të IEVP Kavajë dhe Urdhërit Nr. 624, datë 16.12.2024 të Ministrit të Drejtësisë, "Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale", në bazë të një vlerësimi të detajuar të riskut dhe nevojave individuale të tyre, në funksion të garantimit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore, rehabilitimit social, individualizimit të trajtimit dhe ligjshmërisë të të miturve dhe të rinjve ku pranohen të vendosen në instucion, para moshës 18 vjeçare pasi mbërrijnë në IEVP Kavajë.
2. Të miturit dhe të rinjtë që janë bashkëpunëtorë apo dëshmitarë të drejtësisë mbahen në seksione të veçanta, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" si dhe të marrëveshjeve të nënshkruara në këtë kuadër, duke vlerësuar në çdo rast me përparësi interesin më të lartë të të miturit si dhe nevojat e tij për zhvillim fizik e psikologjik, edukim, shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri.

Neni 8

Siguria e zakonshme për të rinjtë e grupmoshës 18-21 vjeçare

1. Në seksionet e sigurisë së zakonshme vendosen të dënuarit e grupmoshës 18-21 vjeçare sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 18 të Ligjit Nr. 81/2020, Urdhërit Nr.702, datë 29.12.2022 të Ministrit të Drejtësisë mbi ndryshimin e klasifikimit të IEVP Kavajë dhe Urdhërit Nr. 624, datë 16.12.2024 të Ministrit të Drejtësisë "Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale".
2. Të dënuarit e sigurisë së zakonshme përfitojnë të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve lidhur me vizitat, telefonatat, ushqimin, veshjet, trajtimin shëndetësor, ajrimin, pjesëmarrjen në programe rehabilituese dhe punësimin brenda institucionit.

3. Drejtoria e institucionit merr në konsideratë mundësitë për zgjerimin e kohës së ajrimit, dhënien e vizitave shtesë dhe punësimin sipas kapaciteteve dhe infrastrukturës në dispozicion, duke përfshirë planifikimin për leje shpërblyese të grupmohave 18-21 vjeç, sipas kritereve ligjore.

Neni 9

Siguria e ulët për të rinjtë e grupmohës 18-21 vjeçare

1. Transferimi i të dënuarit nga siguria e zakonshme në institucionin apo seksionin e sigurisë së ulët kryhet pasi janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet si vijojnë:
 - a. Janë dënuar për kundërvajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon pesë vjet burgim dhe i dënuari ka kryer jo më pak se 2/3 e dënimit.
 - b. I dënuari është vlerësuar me risk të ulët për arratisje, për shoqërinë dhe komunitetin, për rishkelje.
 - c. Nuk ka asnjë histori të mëparshme të përpjekjes për t'u arratisur.
 - d. Mban qëndrim pendesë ndaj veprës penale dhe nuk mbështet mendimet kriminale.
 - e. Nuk ka kryer shkelje disiplinore të klasifikuara si shumë të rënda apo të rënda, sipas parashikimit të nenit 62 të Ligjit 81/2020 dhe nenit 88 të VKM nr.209/2022 në dy vitet e fundit.
 - f. Nuk ka kontakte me të miturit/riut e përfshirë në organizata të krimit të organizuar ose grupe terroriste.
 - g. Gjatë kryerjes së dënimit është përfshirë vullnetarisht në aktivitete arsimimi dhe formimi profesional, programe rehabilituese dhe rekreative dhe ka dëshmuar përparim.
2. Vendimet për transferimin në regjimin e sigurisë së ulët miratohen nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me propozim të Drejtorisë së Institucionit (IEVP) Kavajë, sipas kritereve ligjore dhe rregulloreve në fuqi.
3. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB vendos për revokimin e vendimit për transferimin e të dënuarit, në rast se gjatë qëndrimit në regjimin e sigurisë së ulët i dënuari:
 - a. ka kryer tentativë për t'u arratisur;
 - b. ka kryer akte dhune që kanë sjellë pasoja për jetën ose shëndetin e stafit, të miturve/rinjve apo vizitorëve;
 - c. ka kryer shkelje të rënda dhe shumë të rënda disiplinore sipas parashikimit të nenit 62 të Ligjit 81/2020 dhe nenit 88 të VKM nr.209/2022;
 - d. kryen shkelje të përsëritura disiplinore qoftë edhe të lehta;
 - e. disponohen të dhëna dhe prova objektive për sjellje, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me rregulloren e përgjithshme të burgjeve, të cilat pamundësojnë qëndrimin e mëtijshëm të të dënuarit në sigurinë e ulët.
4. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në DPB dhe Drejtoria e IEVP kërkojnë informacione nga agjencitë ligjzbatuese për të miturit/ rinjtë e sigurisë së ulët, kur ka të dhëna dhe dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale, dhe i vlerësojnë ato rast pas rasti.
5. Të dënuarve në sigurinë e ulët u garantohen të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me vizitat, telefonatat, sigurimin e ushqimit, veshjeve, trajtimin shëndetësor, ajrimin, përfshirjen në programe rehabilituese dhe punësimin. Drejtoria e Institucionit mban në konsideratë zgjatjen e kohës së ajrimit, dhënien e një vizite shtesë, punësimin brenda dhe jashtë

institucionit, sipas mundësive që lejon infrastruktura dhe planifikimin e të dënuarit për leje shpërblyese, sipas kritereve ligjore.

KAPITULLI IV

PRANIMI DHE VENDOSJA E TË DËNUARVE DHE TË PARABURGOSURVE NË IEVP KAVAJË

Neni 10

Pranimi

1. Pranimi i të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë bëhet në përputhje me nenin 38 të Ligjit Nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe me Kreun III të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022.
2. Në Institucionin Ekzekutimit të vendimeve penale Kavajë pranohet vetëm shtetasit për të cilin gjykata kompetente ka nxjerrë aktvendim për caktimin e masës “arrest në burg” ose dënim me burgim.
3. Pranimi i të miturve kryhet brenda orarit zyrtar të punës, nga ora 08:00 deri në 16:30. Kartelisti ose Specialisti i Drejtimit të Sallës Operative, bën regjistrimin e tij në regjistrin themeltar.
4. Kontrolli personal ndaj të miturve realizohet nga persona të së njëjtës gjini me të miturin ose nga një person i gjinisë së zgjedhur nga vetë i mituri. Në rast kërkesë për kontroll nga person i gjinisë kundërt, kërkesa vlerësohet dhe miratohet ose refuzohet nga Drejtori i Institucionit.
5. Pranimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit të plotë dhe të inventarizuar, që përfshin:
 - a) vendimin e gjykatës për masën e sigurimit “arrest në burg”;
 - b) urdhrin e ekzekutimit nga prokurori;
 - c) procesverbalin e ndalimit ose arrestimit në flagrancë;
 - ç) procesverbalin e kontrollit personal;
 - d) formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
 - dh) dokumentin e identifikimit (letërnjoftim, kartë identiteti, pasaportë biometrike ose tjetër);
 - e) dokumentin e kontrollit mjekësor dhe çdo informacion lidhur me gjendjen shëndetësore të paraburgosurit.
6. Në mungesë të ndonjërit nga dokumentet e mësipërme, institucioni nuk e pranon të paraburgosurin, përveç rasteve të shtetasve të huaj për të cilët pranimi bëhet mbi bazën e dokumenteve të shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “e”.
7. Në rast të paraburgosurve me masë sigurimi “arrest në burg” që ndodhen në institucion mjekësor, pranimi bëhet në atë institucion dhe ata mbahen nën ruajtje nga Policia e Burgjeve.
8. Pas verifikimit të dokumentacionit nga sektori ligjor, kryhen veprimet e nevojshme për pranimin e të miturit, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
9. Staf i institucionit informon të miturin për të drejtën e njoftimit të familjes me telefon për vendndodhjen. Nëse i mituri nuk ka mundësi financiare për të komunikuar, institucioni i siguron këtë mundësi.
10. Përgjegjësi i Sigurisë në Regjimin e Brendshëm është personi i kontaktit për të miturin, i cili trajton çështjet e sigurisë dhe problematikën që lindin gjatë qëndrimit të tij në institucion.

11. Gjatë pranimit, një punonjës i sektorit ligjor së bashku me infermierin bëjnë fotografimin në tri profile të të miturit, matin peshën dhe gjatësinë, regjistrojnë të dhënat personale, shenjat e veçanta, tatuazhet dhe dëmtimet e mundshme. Këto të dhëna administrohen në dosjen personale të të miturit. Fotografimi i të miturve duhet të përsëritet të paktën një herë në tre vjet gjatë ekzekutimit të dënimit.
12. Në rast se gjatë pranimit konstatohen shenja dhune ose dëmtime trupore, ose nëse i mituri shfaq shqetësime shëndetësore, hartohet procesverbal nga personeli shëndetësor, i cili nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit të pritjes dhe përgjegjësi i patrullës së shoqërimit. Ky procesverbal mbahet në tre kopje dhe administrimi i tyre bëhet sipas procedurave të rregullores. Çdo rast i dyshuar për dhunë njoftohet menjëherë organet e procedimit penal dhe Drejtori i Institucionit.
13. I mituri i pranuar ekzaminohet menjëherë nga mjeku i institucionit dhe në rast nevojë dërgohet për vizitë të specializuar.
14. Në rast pranimi jashtë orarit zyrtar, i mituri vendoset në dhomë të veçantë deri në fillimin e orarit zyrtar, kur kryhen veprimet e nevojshme të pranimit.
15. Pranimi i të miturve bëhet mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.
16. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve lëshon urdhërin e akomodimit të të miturit në institucion brenda tre ditëve nga paraqitja e kërkesës zyrtare të Policisë së Shtetit për transferim.

Neni 11

Parandalimi i dhunës dhe trajtimi

1. Drejtorja e Institucionit bën përpjekje për të mbrojtur të miturin/riun nga kërcënimet dhe keqtrajtimet nga ana e bashkëmoshatarëve të tjerë.
2. Të miturve/rinjve që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale para ose gjatë qëndrimit në insitucion, u ofrohet menjëherë masë mbrojtëse, mbështetje psiko-emocionale përmes këshillimit psikologjik, dhe atij ligjor me qëllim rehabilitimin e tyre.

Neni 12

Verifikimi i identitetit

1. Gjatë pranimit të të miturit, të dënuar ose të paraburgosur në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, vërtetohet identiteti i tij në bazë të dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, kartë identiteti, pasaportë biometrike ose çdo dokument tjetër që përmban informacion mbi identitetin).
2. Në rast se i mituri nuk disponon asnjë dokument identifikimi që mund të përdoret për verifikim, përgjegjësi i grupit të shoqërimit duhet të sigurojë një dokument provizor identifikimi, i cili përmban të dhënat në përputhje me vendimin e gjykatës kompetente. Menjëherë pas pranimit, identiteti i personit duhet të verifikohet sa më shpejt të jetë e mundur përmes zyrës së gjendjes civile dhe strukturave të Policisë së Shtetit.
3. Dokumentet mbi bazën e të cilave është vërtetuar identiteti i të mitur/riut të ruhen në dosjen e tij personale.
4. Në rast se i mituri është pranuar pa kartë identiteti, merren masa për pajisjen e tij me kartë identiteti brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj. Numri personal i tij duhet të kërkohet menjëherë nga Drejtorja e Gjendjes Civile, për qëllime regjistrimi në sistem.

5. Sektori Ligjor i IEVP-së dërgon të dhënat e të miturit në zyrën rajonale të gjendjes civile për regjistrimin e shtetasit, jo më vonë se 48 orë pas pranimit të tij me masë sigurie "arrest në burg" ose me dënim me burgim.

Neni 13

Veprimet paraprake gjatë pranimit

1. Menjëherë pas pranimit në mjediset e institucionit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, i mituri i nënshtrohet vizitës ekzaminuese dhe intervistës mjekësore nga mjeku i institucionit, specialisti i sektorit të çështjeve shoqërore, me qëllim njohjen e gjendjes së tij shëndetësore fizike dhe psikologjike, parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse apo vetëvrasjeve si dhe identifikimin dhe regjistrimin e ndonjë shenje apo të dhëne, keqtrajtimit të mëparshëm ose dëmtimi fizik apo mendor që kërkon kujdes mjekësor. Pas ekzaminimit të të miturit, mjeku përgatit një raport, në të cilin përshkruan faktin nëse tek i mituri konstatohen ose jo shenja apo të dhëna, keqtrajttime ose dëmtime fizike a mendore.
2. Shenjat e dëmtimeve fizike të evidentuara gjatë vizitës së pranimit regjistrohen në një regjistër të veçantë, së bashku me shpjegimet rreth rrethanave të shkaktuara. Sektori shëndetësor njofton drejtuesin e institucionit brenda 2 (dy) orëve nga konstatimi. Në rast se ka fakte dhe indicie që ngrenë dyshime për kryerjen e një vepre penale ndaj të miturit, njoftohen organet kompetente të procedimit penal, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.
3. Mjeku, në rast nevojë, pajis të miturin e sapoardhur me raport mjekësor që përmban gjendjen e tij shëndetësore. Një kopje e raportit ruhet në kartelën mjekësore të të miturit dhe i vihet në dispozicion atij.
4. Të miturit i lejohen të kenë sende personale në një çantë me përmasa jo më shumë (70 cm x 25 cm me një peshë 15kg për kuti), ndalohen të futen pajisjet elektroshtëpiake.
5. Komisioni i pritjes kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) Mbikëqyr gjendjen shëndetësore dhe emocionale të të miturit;
 - b) Njohjen me të dhënat personale, familjare, arsimin, veprën penale, shkakun e kryerjes së saj dhe vlerësimin e riskut.
6. Të dhënat individuale për personalitetin e të miturit vlerësohen bazuar në dokumentacionin shoqëruar, shpjegimet e dhëna, formularin e vlerësimit të riskut dhe raportin mjekësor. Bazuar në këto të dhëna, hartohet regjistri i komisionit të pritjes dhe përgatitet plani individual i trajtimit për të mitur/rinjtë.

Neni 14

Kontrolli gjatë pranimit

1. Pas vërtetimit të identitetit, punonjësi përgjegjës për pranimin kryen kontrollin e të miturit dhe të sendeve të tij personale. Në rast se ekziston një dyshim i arsyeshëm që i mituri posedon mjete të ndaluara, duhet të kryhet kontroll trupor nga personeli shëndetësor, me kërkesë të drejtorit të institucionit.
2. Kontrolli trupor dhe i sendeve personale bëhet sipas procedurave të përcaktuara për këtë qëllim. Sendet e ndaluara që i mituri ka me vete ruhen provizorisht dhe mbahet procesverbal i nënshkruar

- nga i mituri dhe punonjësit kontrollues. Këto sende ruhen për një periudhë jo më shumë se 2 muaj, gjatë së cilës familjarët ose personat e autorizuar mund t'i marrin ato.
3. Kontrolli trupor i të miturit kryhet vetëm nga punonjës policie të së njëjtës gjini me të miturin,
 4. Gjatë kontrollit duhet respektuar personaliteti dhe dinjteti i të miturit, duke shmangur çdo formë trajtimi që mund të konsiderohet nënçmues apo ofendues.
 5. Pas përfundimit të kontrollit, hartohet një procesverbal në formë standarde ku regjistrohen sendet që lejohen të mbahen në ambientet e banimit dhe ato që ruhen provizorisht deri në kthimin e tyre. Procesverbali nënshkruhet nga dy punonjës kontrollues dhe nga i mituri. Një kopje e procesverbalit ruhet në dosjen personale të të miturit, ndërsa kopja tjetër i dorëzohet atij.

Neni 15

Vendosja e të paraburgosurve të mitur në IEVP

1. Të miturit e paraburgosur/dënuar vendosen në IEVP Kavajë.
2. Në momentin e pranimin në institucion për të miturit informohen për rregulloren e brendshme të institucionit dhe për të drejtat dhe detyrimet e tij në një gjuhë që kuptojnë ose njohin.
3. Për të miturit që nuk dinë shkrim e lexim, komunikimi i akteve bëhet në mënyrë verbale nga personeli përgjegjës, sipas shërbimeve të specializuara. Në rastet kur fëmija nuk dëgjon ose nuk flet, i garantohet interpretues i gjuhës së shenjave.
4. Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut.
5. Shërbimet duhet të jenë në përputhje me kërkesat e respektimit të shëndetit dhe dinjtetit të të miturit dhe të jenë në funksion të rishoqërizimit, riintegrit, rehabilitimit dhe parandalimit të rikryerjes së veprës penale ose të kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.
6. Për garantimin e interesit më të lartë të të miturit, institucioni duhet të ketë personel të mjaftueshëm, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi.
7. Policia e Shtetit shoqëron të paraburgosurin/dënuarin e mitur duke siguruar dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, VKM Nr. 209, datë 06.04.2022, nenin 104.
8. Sektori ligjor pranë IEVP-së shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e përcjellë nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe nëse është në përputhje me nenin 10 të VKM Nr. 209, datë 06.04.2022, për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, i konfirmon pranimin e të paraburgosurit/dënuar të mitur strukturave të Policisë së Shtetit.
9. Njoftimi i vendosjes së të miturit në institucion, si dhe informimi mbi rregulloren e institucionit apo çdo informacion tjetër i nevojshëm, i jepet menjëherë prindërve apo përfaqësuesit ligjor të të miturit.
10. Në rastet kur i paraburgosuri me masë sigurie "arrest në burg" ndodhet i shtruar në spital ose ka nevojë për trajtim të specializuar shëndetësor, transferimi dhe qëndrimi i tij organizohen nga institucioni, ndërsa ruajtja dhe siguria e tij menaxhohen në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Burgjeve sipas territorit.
11. Çdo vendosje e të paraburgosurve të mitur duhet të bëhet duke respektuar parimet e veçanta të trajtimit të të miturve, përfshirë sigurimin e kushteve të përshtatshme për moshën dhe nevojat e tyre psikologjike, shëndetësore dhe sociale, sipas legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 16

Vendosja e të dënuarve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur dhe të Rinj

1. Vendosja dhe rishpërndarja e të miturve dhe të rinjve bëhet brenda Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë, për këtë kategori, duke marrë parasysh nevojat e sigurisë, trajtimit, dhe rehabilitimit sipas moshës, statusit ligjor (të paraburgosur apo të dënuar), dhe profilit individual.
2. Vendosja duhet të jetë në përputhje me ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të miturve dhe të rinjve, si dhe duke synuar rehabilitimin dhe integrimin e tyre shoqëror.
3. Çdo vendosje apo transferim brenda institucionit dokumentohet dhe justifikohet me një akt administrativ, i cili ruhet në dosjen personale të të miturit, për të garantuar transparencën dhe mbrojtjen ligjore.
4. Në raste emergjente ose për arsye të veçanta shëndetësore, sigurie apo disiplinore, transferimi i të rinjve të moshave 18-21 vjeç mund të bëhet menjëherë, me njoftim të menjëhershëm në organet përgjegjëse dhe me përmbushje të procedurave të mëtejshme administrative.

Neni 17

Komisioni i pritjes

1. Komisioni i Pritjes informon të miturin në një gjuhë të kuptueshme dhe të njohur prej tij për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet, të drejtën për këshillim dhe ndihmë ligjore, si dhe rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesave dhe ankesave, duke i vënë në dispozicion materialet përkatëse. Informacioni i jepet edhe në formë të shkruar.
2. Komisioni i Pritjes përbëhet nga një përfaqësues i sektorit ligjor, një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i sektorit të policisë.
3. Komisioni merr kontaktin e parë me të miturin, njihet me problemet, personalitetin dhe rrezikshmërinë e tij për sigurinë e të burgosurve të tjerë dhe të personelit, dhe e informon për mënyrën e jetesës gjatë kohës së qëndrimit në institucion.
4. Në regjistrin e Komisionit të Pritjes evidentohen të dhënat personale dhe familjare, arsimi, vepra penale për të cilën akuzohet ose është dënuar, konfliktet e mundshme, si dhe rekomandimet përkatëse, të cilat i paraqiten drejtorit të institucionit.
5. Komisioni mbledhet jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga pranimi i të miturit, ose menjëherë në rast nevojë përshpejtim të procedurave për shkak të gjendjes shëndetësore apo rrethanave të tjera emergjente.
6. Komisioni përgatit raportin e pranimi brenda 48 orëve nga mbledhja, i cili përfshin përmbledhjen e gjendjes psikofizike të të miturit, shënimet mbi konfliktet e mundshme dhe rekomandimet për trajtimin e mëtejshëm. Raporti i dorëzohet drejtorit dhe sektorëve përkatës.
7. Në rast emergjencash gjatë periudhës së pritjes, siç janë shfaqja e problemeve të shëndetit mendor ose sjellje të dhunshme, komisioni merr masat e menjëhershme për garantimin e sigurisë dhe kërkon asistencë mjekësore ose psikologjike sipas nevojës.

8. Komisioni ka detyrimin të sigurojë trajtim të barabartë dhe pa diskriminim për të miturin, duke marrë parasysh nevojat individuale dhe duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e tij.

Neni 18

Vendosja e të miturve dhe të rinjve për shkak të sëmundjeve infektive

1. I mituri që diagnostikohet me një sëmundje infektive vendoset në mënyrë të veçantë, larg nga personat e dënuar ose të paraburgosur të tjerë.
2. Vendosja e tillë bëhet me urdhër të drejtorit të institucionit, bazuar në propozimin e mjekut përgjegjës të institucionit.
3. Qëllimi është parandalimi i përhapjes së sëmundjes dhe garantimi i shëndetit të personave brenda institucionit.

Neni 19

Regjistrimi i të dhënave

1. Sektori Ligjor kryen regjistrimin e të miturit sipas të dhënave gjenerale përkatëse, duke përfshirë: emrin, atësinë, mëmësinë, mbiemrin, numrin e identifikimit (ID), datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin, gjininë, shtetësinë, ditën dhe orën e pranimit, veprën penale për të cilën është që dyshohet, masën e dënimit, numrin dhe datën e vendimit, gjykatën që ka dhënë vendimin, si dhe të dhëna të tjera relevante.
2. Këto të dhëna regjistrohen në regjistrin themeltar, në evidencat në sistemin MISP dhe në sistemin e integruar të hedhjes së të dhënave, të monitoruar nga QPKMR. Gjithashtu, bëhet regjistrimi i të miturit edhe në sistemin e menaxhimit të hyrje-daljeve dhe vizitave.

Neni 20

Sendet e lejuara

1. Sendet personale të lejuara për të miturit:

- Dokumentet ligjore;
- Pajisjet mjekësore të përshkruara;
- Sapun;
- Bic për rroje;
- Pastë dhe furçë rroje;
- Shishe plastike me shampo;
- Pastë dhe furçë dhëmbësh;
- Krehër;
- Sende të blera sipas listës nga operatori ekonomik i kontraktuar;
- Një laps dhe një fletore për shkrim;
- Libra dhe fletore shkollore të aprovuara;
- Një palë letra për lojë, shah, domino;
- Tri materiale leximi (libra, materiale religjioze) të kontrolluara dhe monitoruara nga strukturat përkatëse;
- Gazeta dhe revista;
- Ushqim i blerë nga operatori ekonomik i kontraktuar;
- Një palë syze optike (me rekomandim të mjekut).

2. Veshmbathje për të miturit:

- Xhaketë ose xhup/xhuboks;
- Këmisha/nënkëmisha;
- Ndërresa të brendshme;
- Këpucë/atlete;
- Mbathje sportive;
- Triko;
- Sandale;
- Pantallona;
- Pesë palë çorape;
- Rroba sportive;
- Pizhame;
- Palë dorëza (të leshit për periudha të ftohta);
- Tapet për ritualin e faljes (100x50 cm);
- Tapet dhome (200x200 cm);
- Nuk lejohen veshmbathjet me ngjyra të uniformës së policisë së burgjeve.

3. Sendet e pranuar dhe siguruar nga institucioni për të miturit:

- Dy çarçafë;
- Dy batanije;
- Një jastëk dhe këllëf jastëku;
- Dy peshqirë (një i vogël dhe një i madh);
- Një uniformë;
- Një jelek për të dënuarit;
- Gotë plastike për ujë;
- Pjatë plastike për ngrënie;
- Lugë plastike.

4. Paratë:

- Nuk lejohet që i mituri të mbajë para me vete. Paratë duhet të depozitohen në llogarinë personale në emër të tij, përveç nëse ai vendos që paratë ti kthehen familjes menjëherë në momentin e pranimin.

5. Sendet e lejuara në dhomë:

- Një tavolinë plastike dhe stola plastike sipas numrit të të miturve në dhomë;
- Sendet që mund të blihen vetëm përmes operatorit ekonomik të kontraktuar.

6. Pajisjet dhe sendet e ndaluara:

- Nuk lejohet të futet asnjë send ose pajisje që nuk mund të hapet dhe kontrollohet plotësisht në brendësi.

7. Regjistri i sendeve të çmuara:

- Për sendet e çmuara si orë dore, varëse apo unaza (nëse ato ndonjëherë lejohen për të miturit), sektori i sigurisë mban regjistrë të detajuar me markën e sendit, datën e hyrjes dhe të dhënat e të mitur/riu që e zotëron.

8. Sende të lejuara për grupmoshën 18-21 vjeç

1. një orë dore
2. një unazë

3. zinxhir dore ose qafe

Neni 21

Sendet dhe pajisjet e ndaluara në ambjentet e banimit/ të përbashkëta

1. Në mjediset e brendshme të institucionit nuk lejohet të mbahen dhe të qarkullohen nga të miturit/rinjët:
 - a) objektet, mbajtja e të cilave përbën vepër penale;
 - b) sendet që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të miturve/rinjve dhe të personelit, si dhe sigurinë e institucionit;
 - c) pajisje transmetimi dhe komunikimi, përfshirë aparatet celulare, pjesë të tyre dhe çdo lloj aksesori;
 - ç) aparate filmuese dhe fotografike;
 - d) vlera monetare të çdo lloji;
 - dh) pajisje të njëjta me ato që ofrohen nga institucioni, të cilat janë pjesë e mjedisit të banimit apo e mjedisëve të përbashkëta;
 - e) sende me karakter diskriminues apo uniforma ushtarake;
 - ë) bizhuteri, përveç atyre të lejuara sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Brendshme të Institucionit (neni 17);
 - f) pije alkoolike;
2. Sendet e ndaluara të mbajtura nga i mituri/riu, përveç rasteve kur mbajtja e tyre përbën vepër penale dhe konsiderohen si prova materiale, sekuestrohen dhe administrohen nga institucioni dhe i kthehen në momentin e lirit ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga anëtarët e familjes apo persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, sipas autorizimit të lëshuar nga i mitur/riu, kundrejt procesverbalit të firmosur nga marrësi dhe nëpunësi i institucionit.
3. Për sendet, mbajtja e të cilëve përbën vepër penale dhe që konsiderohen provë materiale, ndiqen procedurat ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.
4. Nuk lejohet të futet asnjë send ose pajisje që nuk mund të hapet dhe kontrollohet plotësisht në brendësi.

Neni 22

Hapësira e banimit dhe ndriçimi

1. Të miturve/rinjve, gjatë qëndrimit në institucion, u sigurohen ambiente banimi që përmbushin standardet minimale për sipërfaqe, ndriçim, ajrosje dhe kushte higjiëno-sanitare, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin.
2. Sipërfaqja e dhomave të banimit nuk duhet të jetë më pak se gjashtë (6) metra katrorë për çdo të mitur/ri në dhomë individuale dhe jo më pak se katër (4) metra katrorë për çdo të mitur/ri në dhomat e përbashkëta, duke garantuar hapësirë të mjaftueshme për lëvizje dhe privatësi personale.
3. Të gjitha dhomat e banimit pajisen me dritare të përshtatshme që lejojnë depërtimin e dritës natyrale dhe ajrosjen e vazhdueshme të ambientit. Ndriçimi natyror duhet të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar leximin gjatë ditës.
4. Dhomat e banimit pajisen gjithashtu me ndriçim artificial, të përshtatshëm për aktivitete të përditshme si lexim, studim dhe shkrim, duke respektuar oraret e përcaktuara për fikjen ose ndezjen e ndriçimit gjatë natës, sipas nevojave të të miturit/riut.

5. Gjatë orëve të natës, ndriçimi i mjediseve të banimit mbahet i fikur , përveç rasteve kur:
 - a) ka nevojë mjekësore të veçantë të përcaktuar nga mjeku i institucionit;
 - b) ekziston kërkesë e arsyetuar e të miturit/rinjve dhe është aprovuar nga përgjegjësi i sektorit të brendshëm apo shërbimi shëndetësor;
 - c) në rast se vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme duke plotësuar dokumentacionin përkatës, drita e mjedisit të banimit mund të mbahet e ndezur ose me ndriçim të zbehur.
6. Ambientet e përbashkëta si korridoret, hyrjet, shkallët, ambientet e ajrimit, dhomat e rekreacionit dhe rrugëkalimet mbahen të ndriçuara gjatë gjithë orëve të natës për qëllime sigurie dhe lëvizje të sigurt brenda institucionit.

Neni 23

Orari ditor dhe organizimi i aktiviteteve

1. Të gjitha aktivitetet ditore të të miturve/rinjve në institucion organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e një orari të miratuar nga Drejtori i Institucionit.
2. Orari përshtatet me kushtet stinore, veçoritë strukturore të institucionit dhe profilin e të miturve/rinjve të akomoduar.
3. Zgjatja e kohës së ajrimit për të miturit/rinj të përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke u bazuar në vlerësime të posaçme mbi nevojat e sigurisë, dinamikën institucionale, pjesëmarrjen në programe punësimi, edukimi, trajtimi dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm për mirëqenien dhe risocializimin e tyre.
4. Në varësi të kushteve klimatike dhe temperaturave sezonale, hapja e dyerve të dhomave të banimit për të miturit/rinj të menaxhohet nga administrata e institucionit, duke përjashtuar rastet e incidenteve apo konflikteve të raportuara ndërmjet të miturve/rinjve ose me stafin, në të cilat rastet mund të kufizohet përkohësisht hapja e derës dhe të zbatohet regjim i përforcuar.
5. Kontaktet telefonike, komunikimi me familjen, zhvillimi i programeve argëtuese, kryhen brenda kohës së parashikuar për aktivitetet ditore, pa cenuar rendin dhe sigurinë e institucionit.
6. Apeli për të gjithë të miturit/rinj të bëhet në ambientet e përcaktuara nga drejtuesi i institucionit.
7. Të miturit/rinj të që janë të sëmurë mund të përjashtohen nga prezenca fizike në vendin e apelit, vetëm nëse janë pajisur me raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i institucionit dhe me miratimin e Drejtorit, në të cilin rast apeli bëhet në dhomën e tyre.

Neni 24

Kontrolli/ekzaminimi intim dhe mjekësor i të miturit

1. Kontrolli intim bëhet vetëm me vendim gjykatë përveç rasteve kur shëndeti dhe jeta e të miturit është në rrezik dhe rasteve të jashtëzakonshme me përjashtim të kontrollit të gojës.
2. Kontrolli personal intim i të miturit lejohet kur është absolutisht i nevojshëm, dhe duhet bërë nga persona të të njejtës gjini me të miturin kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni që do të meret mund të humbasë vlerë, ose prova e marrë mund të shkatërrohet.
3. Kontrolli duhet të bëhet në mënyrë që të mos cënohet dinjiteti dhe privatësia e të miturit duke ruajtur interesin më të lartë të të miturit.
4. Çdo shkelje e këtyre rregullave e bën kontrollin e paligjshëm dhe provat e marra të pavlefshme.

Neni 25

Referencat ligjore dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) është përgjegjëse për zbatimin e politikave, procedurave dhe vendosjeve lidhur me vendosjen, rishpërndarjen dhe menaxhimin e të miturve dhe të rinjve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Vendosjet dhe rishpërndarjet e të miturve dhe të rinjve bëhen në përputhje me normat ligjore dhe rregulloret në fuqi, duke respektuar të drejtat e personave të mitur dhe nevojat e tyre rehabilituese.
3. Zbatimi i këtyre përgjegjësi mbështetet në dispozitat e ligjit nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", veçanërisht në nenin 23, pika 4, si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr. 209, datë 6.4.2022, në nenin 11.
4. DPB ka detyrën të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme respektimin e këtyre dispozitave dhe të ndër marrë masat e nevojshme për garantimin e sigurisë, trajtimit të duhur dhe rehabilitimit të të miturve dhe të rinjve të dënuar apo në paraburgim.

KAPITULLI V

NJOHJA ME JETËN NË INSTITUCION

DHE

TË DREJTAT E DETYRIMET E TË MITURVE/RINJVE

Neni 26

Sistemimi në dhomat e banimit

1. Të miturit dhe të rinjve në Institucionin e të miturve dhe të rinjve (IEVP) Kavajë u garantohej akomodimi individual në dhomat e banimit, duke iu vënë në dispozicion:
 - një krevat personal,
 - dyshek,
 - jastëk me këllëf,
 - dy çarçafë dhe një ose më shumë batanije, sipas stinës,
 - si dhe një komodinë për ruajtjen e sendeve personale, në përputhje me normat teknike dhe standardet e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi.
2. Përpara vendosjes në dhomë, çdo i mitur apo i ri i paraburgosur apo i dënuar, i nënshtrohet një vlerësimi të posaçëm të riskut dhe nevojave, që përfshin faktorë si:
 - rrezikshmëria e veprës penale,
 - historiku i dhunës apo konflikteve të mëparshme,
 - sjellje antisociale (p.sh. bullizëm, urrejtje, ekstremizëm),
 - çrregullime të shëndetit mendor,
 - përdorimi i lëndëve narkotike,
 - orientimi seksual,
 - dhe çdo tregues tjetër që mund të ndikojë në dinamikën e dhomës së banimit.
3. Vlerësimi dhe vendosja në dhomën e banimit bëhet nga një Komision i Akomodimit, i përbërë nga:
 - përgjegjësi i sektorit të çështjeve shoqërore,
 - përgjegjësi i sektorit të kujdesit shëndetësor,
 - shefi i policisë (ose polici përgjegjës).

Komisioni plotëson një formular zyrtar të vendosjes, ku pasqyron sektorin dhe dhomën e përshtatshme. Në rast të ndryshimeve të mëvonshme (p.sh. rishpërndarje për arsye sigurie apo sociale), e njëjta procedurë rishikohet dhe zbatohet.

4. Në rast konflikti të papritur midis të miturve në të njëjtën dhomë, ose kur ekzistojnë informacione të besueshme për cenim të sigurisë:
 - përgjegjësi i regjimit të brendshëm, në bashkëpunim me shefin e policisë, urdhëron menjëherë shpërndarjen provizore të të miturve,
 - deri në rishqyrtimin e çështjes nga Komisioni i Akomodimit, që merr vendim të ri mbi vendosjen përfundimtare.
5. I mituri/riu ka për detyrë të mbajë dhomën e tij të pastër dhe të rregullt, përfshirë shtretin, çarçafët dhe sendet e tjera personale.
6. Sendet personale duhet të ruhen në mënyrë të organizuar në komodinën e dedikuar për to, ndërsa shtretërit të jenë të sistemuar çdo ditë në orarin e përcaktuar nga rregullorja e brendshme.
7. Çdo dëmtim i qëllimshëm i inventarit shtetëror (mobiljeve, pajisjeve ose objekteve në dhomë) nga i mituri/riu, sjell:
 - përgjegjësi administrative për zhdëmtimin në vlerën reale sipas çmimeve të miratuara, brenda afatit 30-ditor nga dita e konstatimit të dëmit;
 - në rast se dëmtimi është me dashje dhe synon cënimin e sigurisë së institucionit, ndjekja penale ndaj të miturit/riut bëhet në përputhje me legjislacionin penal në fuqi, dhe kallëzimi penal i referohet prokurorisë kompetente.

Neni 27

Veshja e të mitur/riut

1. Të miturit dhe të rinjtë, u lejohe të mbajnë veshjet e tyre personale në vartësi të stinës dhe kushteve klimaterike.
2. Duhet të mbajnë rrobat e tyre me rregull, pastër e në gjendje të mirë gjatë gjithë kohës. Humbja e rrobave të institucionit duhet të raportohet tek punonjësi përgjegjës për seksionin përkatës të banimit.
3. Shkëmbimi, huazimi, shitja apo dhënia e rrobave apo ndërresave të një të mitur/riu tjetër është e ndaluar.
4. Nëse i mituri/riu që nuk mban rroba apo ndërresa personale do të pajisen me rrobat e nevojshme të institucionit.
5. Larja apo hekurosja e rrobave personale, bëhet nga vetë i mitur/riu ose nga familjarët e tyre.

Neni 28

Ajrimi

1. Të miturit e paraburgosur ose të dënuar kanë të drejtë për ajrimin ditor, jo më pak se 2 (dy) orë në ditë dhe të paktën 2 (dy) herë në ditë, përveç kohës për veprimtari social-edukative.
2. Kohëzgjatja maksimale e ajrimit përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, duke u bazuar në:
 - karakteristikat e institucionit,

- nevojat e sigurisë,
 - dinamikën e veprimtarive social-edukative dhe programet individuale të të miturve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas për mbrojtjen e të miturve.
3. Koha e ajrimit në ambientet e hapura zhvillohet në përputhje Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nga ora 08:00 deri në orën 16.00 gjatë verës dhe nga ora 08-14:00, gjatë stinës së dimrit duke respektuar:
 - kushtet klimatike,
 - sigurinë institucionale,
 - integritetin fizik dhe mendor të të miturit,
 - si dhe nevojat individuale të parashikuara në planin e trajtimit.
 4. Në raste të veçanta, për të miturit e sëmurë lejohet ajrimi shtesë, me rekomandim të mjekut të institucionit, i cili duhet të shpjegojë me shkrim arsyet e dhënies së kohës shtesë për ajrim si dhe kohë zgjatjen.
 5. Dalja në ajrim bëhet me dhoma ose individualisht. Në dalje dhe në hyrje bëhet kontrolli fizik i të miturve/rinjve. Gjatë kohës së ajrimit mund të zhvillohet veprimtari kulturore dhe sportive nga të miturit.
 6. Gjate kohës së ajrimit veprimet e të miturve vëzhgohen.
 7. Në rast se konstatohen shqetësime, ndërpritet ajrimi, të miturit futen nëpër dhoma dhe raportohet tek Specialisti i Drejtimit të Sallës Operative duke përpiluar edhe një procesverbal. Për arsye sigurie dalja në ajrim e të miturve bëhet dhe jashtë orareve të grafikut të miratuar.

Neni 29

Higjiena

1. Të miturve/rinjve u sigurohen pajisje dhe mjetet e nevojshme për higjienën personale dhe të ambienteve.
2. Institucioni organizon shërbime periodike për pastrimin e hapësirave, veshmbathjes dhe pajisjeve personale, si dhe kryen qethjen e flokëve, duke garantuar kontrollin e tyre jo më rrallë se një herë në javë.
3. Higjiena personale mund të bëhet me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjiëno-sanitare, sipas kërkesës së shërbimit shëndetësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.
4. I mituri/riu është i detyruar të mbajë higjienën personale dhe atë të përgjithshme çdo ditë.
5. Ndërresat, çarçafët dhe këllëfi i jastëkut ndërrohen të paktën një herë në pesëmbëdhjetë (15) ditë, ndërsa batanijet të paktën çdo tre (3) muaj. Rrobat dhe ndërresat personale lahen dhe thahen në lantanerinë e institucionit.
6. Të miturve/rinjve u garantohet e drejta për t'u larë në dushe, jo më pak se dy herë në javë dhe gjithashtu pas çdo aktiviteti fizik, sportiv apo pune. Dushet duhet të jenë të përshtatshme dhe të sigurojnë privatësinë e personit.

Neni 30

Njohja me të drejtat dhe detyrimet

1. Menjëherë pas pranimit në institucion i mituri informohet me shkrim për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, rehabilitimit, ose qëndrimit në paraburgim.

2. Në rastet kur i mituri nuk di shkrim dhe lexim, informacioni i domosdoshëm i komunikohet në mënyrë verbale nga punonjësit përgjegjës të institucionit.
3. Për të miturit/rinj të që janë shtetas të huaj, informimi bëhet nëpërmjet një përmbledhjeje të shkruar të rregullave kryesore në një nga gjuhët ndërkombëtare (si anglisht, frëngjisht etj.), ose, nëse është e mundur, në gjuhën e tyre amtare.
4. Institucioni harton një fletë palosje informuese, që përmban:
 - të drejtat dhe detyrimet e të miturve/rinjve,
 - informacion për vizitat,
 - përfitimet dhe procedurat për ankesat,
 - rregullat e brendshme dhe masat disiplinore.
5. Për çdo grup prej 15–20 të miturish/rinjsh, caktohet një Përgjegjës i Sigurisë në regjimin e brendshëm si pikë kontakti, i cili ka për detyrë:
 - të koordinojë trajtimin e kërkesave dhe ankesave,
 - të ndihmojë në organizimin e vizitave,
 - të ndjekë procedurat për akomodimin dhe çështjet e tjera të përditshme.

Neni 31

Të drejtat e të miturve/rinjve

1. Të miturit/rinj të trajtohen sipas akteve ligjore në fuqi, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, mbi çfarëdo baze, përfshirë: gjininë, racën, ngjyrën, përkatësinë etnike, gjuhën, fenë, bindjen politike, fetare ose filozofike, orientimin seksual, identitetin gjinor, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësinë prindërore, moshën, gjendjen martesore, shëndetin, aftësinë e kufizuar, shtetësinë ose përkatësinë në një grup të caktuar.
2. Të miturve/rinjve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet:
 - trajtim i barabartë dhe jo diskriminues;
 - respektimi i integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor;
 - kujdes sipas standardeve shëndetësore kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Të miturve/rinjve me aftësi të kufizuara u garantohet:
 - trajtim i barabartë dhe jo diskriminues;
 - akses në shërbime të posaçme për aftësimin dhe riaftësimin e tyre;
 - realizimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.
4. Të miturit/rinj të me shtetësi të huaj ose pa shtetësi trajtohen duke marrë në konsideratë situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Institucioni ndërmerr masa për të shmangur çdo formë diskriminimi dhe për të zgjidhur problematikat që lidhen me qëndrimin në institucion, transferimin ose lirin e tyre.
5. Masat e veçanta që ndërmerren për grupe të caktuara të miturish/rinjsh me nevoja specifike nuk konsiderohen diskriminim, por trajtim i nevojshëm për garantimin e të drejtave të tyre.
6. Gjatë qëndrimit në institucion, të miturve/rinjve u garantohen, ndër të tjera, këto të drejta:
 - Takime dhe korrespondencë me avokatët, me kohë të mjaftueshme dhe në konfidencialitet të plotë;
 - Informim të vazhdueshëm për të drejtat e tyre;
 - Fjetje në krevat individual me mjetet e nevojshme (çarçafë, batanije etj.);
 - Ushqim tre herë në ditë, sipas standardeve ushqimore;
 - Mbajtjen e një llogarie bankare personale për nevojat e tyre;

- Takime me familjarët dhe persona të tjerë të autorizuar;
- Shërbim shëndetësor 24 orë në ditë;
- E drejta për të paraqitur kërkesa dhe ankesa pranë autoriteteve të institucionit ose të jashtme;
- Fshehtësia e korrespondencës dhe bisedave telefonike;
- E drejta për ajrim të përditshëm;
- Pjesëmarrje në aktivitete argëtuese, edukative dhe rehabilituese;
- Pjesëmarrje në punësim apo aktivitete prodhuese/arsimore, kur është e mundur;
- Ushtrimi i lirë i besimit fetar dhe riteve përkatëse;
- E drejta për ndihmë sociale dhe psikologjike;
- Përdorimi i sendeve personale të lejuara nga rregullorja;
- Çdo e drejtë tjetër e parashikuar në legjislacionin kombëtar;
- E drejta e votës, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera përkatëse;
- Të miturit/rinjtë shtetas të huaj kanë të drejtë të komunikojnë me përfaqësitë diplomatike të shtetit të tyre.

Neni 32

Proceduara e vlerësimit të rrezikshmërisë

1. Menjëherë pas njohjes me të drejtat dhe detyrimet e tij, për çdo të mitur/riu bëhet një vlerësim paraprak i nevojave psikologjike, shëndetësore dhe të sigurisë.
2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të qëndrimit në institucion, për çdo të mitur kryhet vlerësimi i riskut, i cili përfshin:
 - a) Rrezikun e arratisjes dhe pasojat që mund të ketë kjo për publikun;
 - b) Rrezikun për sigurinë, rendin, jetën e të tjerëve dhe të vetes;
 - c) Çdo rrezik tjetër që mund të ndikojë në realizimin e objektivave dhe misionit për rehabilitim.
3. Për vlerësimin e riskut, personeli i institucionit shqyrton, analizon dhe vlerëson çdo faktor që mund të ndikojë në sjelljen e të miturit në institucion, duke përfshirë:
 - a) Historinë kriminale dhe sjelljen antisociale;
 - b) Paaftësinë për menaxhimin e emocioneve;
 - c) Agresivitetin;
 - ç) Kushtet e jetesës në institucion;
 - d) Konfliktet e mundshme me të miturit e tjerë;
 - dh) Problemet familjare;
 - e) Nivelin e edukimit, punësimin, menaxhimin e kohës së lirë, gjendjen financiare dhe ambientin ku jeton;
 - ë) Probleme me substanca narkotike, psikotrope ose alkool;
 - f) Gjendjen e shëndetit mendor.
4. Format i formularit të vlerësimit të riskut miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.
5. Komisioni harton raportin e vlerësimit të rrezikshmërisë në rastet e kërkuara nga Gjykata ose DPB kur ka nevojë për ndryshimin e klasifikimit të sigurisë së të dënuarit, përfshirë kalimin ndërmjet institucioneve me nivele të ndryshme sigurie dhe vendosjen në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë.

6. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të riskut, për të miturin hartohet planifikimi i menaxhimit të riskut dhe ndërhyrjeve të nevojshme.
7. Raporti protokollohet nga sektori përkatës dhe një kopje e tij administrohet në dosjen personale të të dënuarit
8. Vlerësimi i riskut rishikohet periodikisht, por jo më rrallë se një herë në vit.

Neni 33

Detyrimet e të miturve/rinjve

Të miturit dhe të rinjtë, gjatë qëndrimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, kanë detyrimin të respektojnë rregulloren e brendshme të institucionit, kuadrin ligjor në fuqi si dhe duke treguar sjellje korrekte ndaj të miturve/rinjve të tjerë dhe personelit të institucionit.

1. Aktivitetet

Të miturit/rinj të inkurajohen dhe kanë për detyrë të marrin pjesë në veprimtari edukative, kulturore, sportive dhe në programe të mundshme punësimi dhe vetëpunësimi, në përputhje me planin individual të trajtimit.

2. Sjellja dhe respektimi i rregullave

Të miturit/rinj të janë të detyruar të:

- respektojnë rregullat e jetesës në institucion;
- krijojnë marrëdhënie korrekte me të miturit/rinj të tjerë dhe me personelin;
- ndjekin dhe zbatojnë udhëzimet e dhëna nga punonjësit e institucionit.

3. Detyrimet specifike

Gjatë gjithë periudhës së qëndrimit në institucion, i mituri/riu ka për detyrim ligjor:

- a) të mbajë të pastër dhe të rregullt mjedisin e banimit dhe mjediset e përbashkëta;
 - b) të kujdeset për higjienën dhe pamjen personale;
 - c) të mos mbajë, përdorë apo qarkullojë sende të ndaluara sipas nenit 31 të kësaj rregullore, të rrezikshme për sigurinë, jetën ose shëndetin e të miturve/rinjve dhe personelit, si dhe sende që përbëjnë vepër penale ose që ndikojnë në procesin hetimor;
 - ç) të ruajë marrëdhënie respektuese dhe të mos përfshihet në sjellje provokuese, bullizuese apo diskriminuese ndaj të miturve/rinjve të tjerë;
 - d) të respektojë udhëzimet dhe vendimet e punonjësve të institucionit në përputhje me detyrat e tyre funksionale;
 - dh) të dëmshpërblejë dëmet e shkaktuara në pronën e institucionit apo të të miturve/rinjve të tjerë, sipas çmimeve të inventarit, në rast se dëmtimi është i qëllimshëm ose për faj të tij;
 - e) të marrë pjesë rregullisht në aktivitetet ditore të përcaktuara në planin ditor të institucionit;
 - ë) të respektojë dinjitetin njerëzor dhe të drejtën për një mjedis të sigurt për çdo pjesëtar të komunitetit të institucionit;
 - f) të informojë menjëherë personelin drejtues për çdo rrethanë që mund të cenojë sigurinë, shëndetin, apo që përbën shkelje të rregullave të institucionit.
- b) Rutina ditore e veprimtarisë në regjimin e brendshëm është përcaktuar me urdhër të Drejtorit të institucionit.

KAPITULLI VI

USHQIMI, TRAJTIMI SHËNDETËSOR DHE ZBATIMI I MASAVE HIGJENIKE

Neni 34

Ushqimi

1. Të miturve/rinjve i garantohet ushqim nga institucioni në 3(tre) vakte, sipas orarit të veprimeve, në përputhje me normat dhe llojshmërinë e përcaktuar në urdhërin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Ushqimi para se të shpërndahet kontrollohet nga Specialisti i Drejtimit të Sallës Operative Infermieri. Proçesi i shpërndarjes dhe kontrollit të ushqimit dokumentohet gjithashtu dhe kampionet e ushqimit ruhen në frigorifer ftohës.
3. I mituri/riu ka të drejtë të blejë produkte ushqimore dhe sende të tjera të lejuara nga operatori i kontraktuar, duke përdorur të ardhurat e tij personale të depozituara në llogarinë bankare.
4. Sektori i shërbimeve me sektorin e shëndetësisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB), siguron dietë të veçantë për të miturit/rinj të që kanë nevojë shëndetësore, në përputhje me rekomandimet e mjekut.
5. Menuja e vakteve përcaktohet nga personeli kompetent i institucionit, në përputhje me udhëzimet dhe normat e ushqimit të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
6. Sektori i Kujdesit Shëndetësor, ai i policisë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore e Shërbimeve përpilojnë raport të përbashkët të hollësishëm mbi sasinë e ushqimit, duke e ndarë sipas kategorive të të miturve/rinjve.
7. Shpërndarja e ushqimit në të tri vaktet bëhet nga kuzhinieri, i shoqëruar nga punonjës të policisë.
8. Shpërndarja e ushqimit bëhet me pajisje të institucionit me inventar fizik dhe dokumentacion dhe pas konsumit të ushqimit/vaktit pajisjet merren nga kuzhinieri duke u dorëzuar sipas inventarit me shënimet përkatëse.

Neni 35

Shërbimet e kujdesit shëndetësor

Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen në përputhje me parashikimet e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr. 209, datë 06.04.2022, si dhe Ligjin Nr. 81/2020.

1. Shërbimi shëndetësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit të të miturve/rinjve në institucion, duke garantuar të njëjtin trajtim dhe kujdes që zbatohen për shoqërinë në përgjithësi, në përputhje me procedurat standarde të veprimit sipas problematikës individuale. Ky kujdes mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kushtet, mjetet dhe personeli i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit të të miturve/rinjve sigurohen nga shteti.
3. Shërbimi shëndetësor i përgjigjet çdo kërkesë të të miturve/rinjve lidhur me shëndetin e tyre dhe kryen kontrole periodike për monitorimin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore, me theks të veçantë në shëndetin mendor. Çdo kontroll dokumentohet në kartelën shëndetësore të të miturit/riut.
4. Shërbimet e kujdesit shëndetësor sigurojnë:
 - a) Parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve;
 - b) Furnizimin me barna dhe pajisje mjekësore në raste emergjence, kur këto nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm;
 - c) Profilaksinë e sëmundjeve, me kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ngjitëse;

- d) Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të miturve/rinjve;
 - e) Mbajtjen nën kontroll të sëmundjeve kronike.
5. Mjeku i institucionit raporton drejtorit të institucionit sa herë vlerëson se gjendja fizike ose mendore e të miturit/riut është përkeqësuar ose mund të përkeqësohet për shkak të qëndrimit në institucion.
 6. Institucioni garanton shërbim shëndetësor 24 orësh. Orari i vizitave mjekësore është nga ora 09:30 deri në 14:00. Jashtë këtij orari kryhen vetëm vizita urgjente.
 7. Vizitat mjekësore kryhen në dhomat e mjekut dhe stomatologut, në kushte konfidencialiteti dhe pa praninë e personelit të sigurisë, përveç rasteve kur vlerësohet se pacienti paraqet rrezik për stafin dhe kërkohet nga mjeku.
 8. Personeli shëndetësor kontrollon çdo mëngjes ambientin ku qëndron i mituri/riu, verifikon higjienën dhe merr kërkesat për vizita mjekësore dhe stomatologjike.
 9. Në institucion funksionon shërbimi stomatologjik, i cili ofrohet çdo ditë nga ora 09:30 deri në 14:00. Trajtimet specializuara jashtë kapaciteteve të institucionit mund të kryhen në institucione private, me kërkesë dhe miratim nga drejtoria, duke mbuluar shpenzimet vetë i miturit/riu.
 10. Institucioni disponon shërbim farmaceutik për mbështetjen e parandalimit dhe ruajtjes së shëndetit të të miturve/rinjve.
 11. Çdo i mitur/ri ka të drejtë të kërkojë vizita të mjekë specialistë, duke mbuluar shpenzimet përkatëse. Në raste urgjente ose sipas rekomandimit të mjekut specialist, i mituri/riu dërgohet në spitale publike me miratimin e drejtorit dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara.
 12. Jashtë orarit zyrtar, në raste emergjence, personeli shëndetësor, me miratimin e specialistit të informacionit, organizon transferimin e të miturit/riut të sëmurë në spital publik, duke respektuar rregullat e sigurisë.
 13. I mituri/riu që dyshohet ose konfirmohet me sëmundje ngjitëse izolohet menjëherë në ambiente të përshtatshme dhe trajtohet sipas standardeve të njëjta si personat jashtë institucionit.
 14. Në rastet kur trajtimi i sëmundjeve infektive nuk mund të realizohet brenda institucionit, i mituri/riu dërgohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve.
 15. I mituri/riu është i detyruar të zbatojë udhëzimet e mjekut gjatë trajtimit. Mbajtja dhe përdorimi i barnave bëhet vetëm nga personeli shëndetësor sipas përshkrimeve në kartelën mjekësore.
 16. Të miturve/rinjve u lejohe përdorimi i barnave që sjellin familjarët ose i blejnë vetë, në rast se nuk disponohen në farmacinë e institucionit, me rekomandimin e mjekut të institucionit. Mbajtja e barnave për administrim të vetëdijshëm apo çdo abuzim tjetër është e ndaluar.
 17. Të miturit/ri që janë ish-përdorues të lëndëve narkotike mund të trajtohen me metadon apo barna të tjera vetëm me rekomandim të mjekut specialist, me administrim të kontrolluar nga personeli shëndetësor.
 18. Janë të ndaluara eksperimentet mjekësore që mund të shkaktojnë dëmtime fizike, çrregullime mendore ose pasoja të tjera të të miturit/rinj.

Neni 36

Kërkesa për vizitë mjekësore

1. I mituri/riu që ka probleme shëndetësore referon nevojën për vizitë mjekësore tek personeli shëndetësor ose tek personeli i sigurisë në regjim. Personeli shëndetësor i turnit harton listën

- përkatese dhe ia dorëzon mjekut të institucionit për të kryer vizitat, me përjashtim të rasteve urgjente.
2. Lëvizja e të miturve/rinjve nga dhoma për në infermieri dhe anasjelltas, përveç rasteve urgjente, bëhet një nga një, sipas kërkesës së mjekut. Gjatë vizitës mjekësore, punonjësi shoqëruar qëndron jashtë dhomës deri në përfundim të vizitës.
 3. I mituri/riu nuk ka të drejtë të mbajë apo përdorë asnjë lloj medikamenti pa miratimin paraprak të mjekut.

Neni 37

Shërbimi dhe kujdesi shëndetësor

1. Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor. Të miturit dhe rinjtë në IEVP Kavajë, të cilët vuajnë nga çrregullime të tilla, kanë të drejtë për trajtim të veçantë shëndetësor.
2. Trajtimi shëndetësor i të miturve dhe rinjve përfshin kontrolle të plota për përcaktimin e nevojave për kujdes parësor shëndetësor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kontrollin për:
 - a. Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme (SST);
 - b. Sëmundje të lindura të gjakut;
 - c. Kujdesin për shëndetin mendor;
 - d. Çrregullime post-traumatike;
 - e. Rrezikun e vetëdëmtimit ose vetëvrasjes;
 - f. Praninë e varësisë ndaj lëndëve narkotike;
 - g. Abuzimin seksual dhe format e tjera të dhunës të mundshme para pranimi në institucion.
3. Të miturve dhe rinjve u ofrohen programe dhe shërbime në përputhje me moshën e tyre, duke u informuar mbi kujdesin shëndetësor, parandalimin e sëmundjeve, higjienën personale, format e dhunës dhe çdo lloj abuzimi.
4. Të miturve dhe rinjve u sigurohet kontroll periodik nga mjeku psikiatër dhe specialistë të tjerë mjekësorë.
5. Ata që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, substancave psikotrope ose alkoolit, apo shenja të stresit, trajtohen sipas programeve shëndetësore dhe sociale të zbatuara në komunitet dhe protokolleve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
6. Personat me sëmundje infektive trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe sipas standardeve të institucioneve spitalore përkatëse.
7. Gjatë pranimi, të miturit dhe rinjtë vlerësohen për rrezikun e vetëdëmtimeve dhe vetëvrasjeve nëpërmjet formatit standard. Në rast identifikimi të shenjave, mendimeve apo rrethanave që paraqesin rrezik, ndërmerren masa të menjëhershme për monitorim, sistemim dhe zbatim të planit të ndërhyrjes. Personat në këtë kategori nuk sistemohen kurrë në dhomë të vetmuar dhe mbahen nën vëzhgim të vazhdueshëm nga punonjësi i sigurisë, me derën e papenguar.
8. Rastet e refuzimit të ushqimit trajtohen në përputhje me protokollin standard të miratuar.
9. Kufizimet fizike i të mitur/riu me probleme të shëndetit mendor bëhen në përputhje me ligjin për shëndetin mendor, me rekomandim të mjekut psikiatër dhe sipas formatit standard të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Mënyrat e kufizimit përfshijnë përdorimin e medikamenteve, imobilizimin fizik (jelekun e forcës), përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik dhe izolimin. Ndalohen përdorimi i prangave metalike ose plastike për kufizim, përveç rasteve kur i mitur/riu paraqet rrezik për vetëdëmtim.

10. Për koordinimin e trajtimit të të miturve dhe rinjve me probleme të shëndetit mendor caktohet një punonjës përgjegjës si koordinator i ekipit multidisiplinar.

Neni 38

Shërbimi i kujdesit shëndetësor jashtë institucionit

1. Nëse i mituri/riu ka nevojë për trajtim shëndetësor, i cili nuk ofrohet nga shërbimet e kujdesit shëndetësor të institucionit ose kërkohet prej tij, merren masat për transferimin në shërbimet e kujdesit shëndetësor jashtë institucionit vetëm me miratimin paraprak të drejtorit të institucionit. Gjatë transportimit, të miturit/rinjtë shoqërohen nga personeli shëndetësor dhe punonjësit e policisë.
2. Të miturve dhe rinjve u lejohet të kryejnë vizita dhe mjekime të specializuara në klinika jashtë institucionit, me shpenzimet e tyre personale kryhet në rast se shërbimet e nevojshme nuk mund të ofrohen në spitalet publik dhe me miratimin paraprak të Drejtorit të Institucionit. Në këtë rast, duhet të merret parasysh afërsia e klinikës me institucionin.
3. Numri i punonjësve të sigurisë që bëjnë shoqërimin e të miturit/të riu të sëmurë në shërbimet e kujdesit shëndetësor jashtë institucionit caktohet në varësi të situatës, rrezikshmërisë, ambienteve, por në asnjë rast jo më pak se 3 (tre) punonjës sigurie për një të mitur/ri.
4. Vizitat caktohen në fshehtësi të plotë, në bazë të marrëveshjeve të posaçme me drejtuesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor jashtë institucionit.
5. Vizitat jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe mbikëqyrja spitalore kryhen bazuar në procedurën e sigurisë gjatë shoqërimeve, duke ruajtur konfidencialitetin e plotë të lëvizjeve dhe shmangur çdo lloj komunikimi dhe kontakti.
6. Transporti dhe ruajtja e të miturve dhe rinjve (hospitalizimi) gjatë këtyre vizitave sigurohet nga institucioni, duke u shoqëruar nga personeli shëndetësor dhe punonjësit e policisë. I mituri/riu i sëmurë që shtrohet në spital mbikëqyret nga punonjësit e policisë i pa prangosur.
7. Në rastet kur të miturit/të rinjtë janë të vlerësuar me nivel të lartë rrezikshmërie për t'u arratisur dhe kur shoqërohet jashtë dhomës ku është i shtruar, kryhet rivlerësimi i situatës (rivlerësim rrishtu) dhe mund të përdoren mjete kufizuese për të parandaluar ndonjë arratisje të mundshme.
8. Në rastet kur vlerësohet ekzistenca e një rreziku të shtuar për arratisje nga të miturit/ rinjtë ose për sigurinë e jetës së personelit shëndetësor dhe të sigurisë, kryhet rivlerësimi i situatës (rivlerësim rrishtu) nga punonjësi i sektorit sigurisë i rolit mesëm ose personi përgjegjës dhe njoftohet Zyra e Informacionit, Drejtimit & Emergjencës, Shefi Sigurisë, Drejtori Institucionit dhe merren masa për të shtuar personelin mbikëqyrës dhe përdoren si mjet i fundit mjetet kufizuese.

Neni 39

Medikamentet mjekësore, sigurimi dhe shpërndarja e tyre

1. Pas vizitës mjekësore, mjeku i institucionit ose mjeku specialist, në varësi të llojit të sëmundjes së të miturve/rinjve, rekomandon trajtimin e nevojshëm, i cili dokumentohet në kartelën mjekësore të të miturit/riut. Njëkohësisht, personelit shëndetësor dhe farmacistit u jepen udhëzimet e nevojshme për veprimet e mëtejshme.
2. Administrimi i medikamenteve kryhet nga farmacia e institucionit, ndërsa shpërndarja e tyre bëhet nga personeli shëndetësor i autorizuar.

3. Me miratimin dhe udhëzimin e mjekut të institucionit, të miturit/riut mund t'u lejohet trajtimi me medikamente të siguruara me shpenzimet e tyre personale.

Neni 40

Veçimi Mjekësor

1. Në rastet e sëmundjeve ngjitëse, mjeku vendos për veçimin e të miturit/riut, duke e mbajtur atë nën monitorim të vazhdueshëm dhe duke njoftuar menjëherë drejtorin e institucionit për situatën.
2. Në rastet e konstatimit të sëmundjeve ngjitëse, dhoma dezinfektohet sipas protokolleve përkatëse, ndërsa i mituri/riu vendoset në një ambient të veçantë për izolim ose dërgohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve për trajtim të specializuar.
3. Mjeku vendos për ndërprerjen e veçimit vetëm pasi të jenë eliminuar shkaqet që e kanë bërë të nevojshëm izolimin.

Neni 41

Konfidencialiteti i të dhënave mjekësore

1. Kartela mjekësore e të miturit/riut administrohet ekskluzivisht nga mjeku dhe ruhen në mënyrë të mbyllur dhe të sigurt, në përputhje me rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës.
2. Fotokopje e kartelës mjekësore vihet në dispozicion vetëm gjykatës dhe prokurorisë, vetëm me kërkesë të shkruar. Mbrojtësit ligjor të të miturit/riut u jepet informacion shëndetësor bazuar në përmbajtjen e kartelës mjekësore, pa dhënë fotokopje të saj.

Neni 42

Kërkesat dhe ankesat

1. Kërkesat dhe ankesat bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.
2. Drejtori i Institucionit i trajton vetë ose delegon sektorin përkatës për verifikimin, zgjidhjen dhe raportimin e kërkesave dhe ankesave.
3. Sekretaria e institucionit mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe ankesave të të miturve/rinjve, në formë shkresore dhe elektronike. Formati dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
4. Afati i shqyrtimit të ankesave varet nga lloji i kërkesës, por nuk mund të tejkalojë afatet e parashikuara në ligj.
 - a) Kërkesat dhe ankesat në kompetencë të sektorëve të IEVP Kavajë trajtohen brenda një periudhe prej 1 deri në 5 ditë pune.
 - b) Kërkesat dhe ankesat në kompetencë të Drejtorit të IEVP Kavajë trajtohen brenda një periudhe prej 1 deri në 10 ditë pune.
 - c) Kërkesat dhe ankesat që janë jashtë kompetencës së IEVP Kavajë trajtohen brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse.

KAPITULLI VII

TRAJTIMI I TË MITURVE/RINJVE

Neni 43

Korrespondenca

1. Çdo i mitur/ri ka të drejtë të mbajë korrespondencë private, e cila duhet të trajtohet me respekt për fshehtësinë dhe integritetin e saj.
2. Për të miturit/rinj që nuk kanë mundësi materiale për të ushtruar të drejtën e korrespondencës, institucioni siguron mjetet e nevojshme pa pagesë.
3. Korrespondenca dorëzohet në kutinë postare të IEVPKavajë, e cila merret dhe administrohet nga një punonjës i caktuar i institucionit, i cili garanton ruajtjen e fshehtësisë së përmbajtjes.
4. Në rastet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se në korrespondencë mund të ketë sende të ndaluara ose përmbajtje të paligjshme, ajo mund të hapet dhe kontrollohet vetëm në prani të të miturit/riut dhe drejtorit të institucionit, duke ruajtur dinjitetin dhe të drejtat e personit.
5. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, mund të kufizojë të drejtën e të miturit/riut për korrespondencë, vetëm në rastet kur kjo është e nevojshme për zhvillimin e procedurave ligjore ose për mbrojtjen e sigurisë institucionale.
6. Korrespondenca që i drejtohet gjykatave, prokurorisë, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Europës, apo konsullatave të vendeve të huaja (për rastet e të mitur/rinjve me shtetësi të huaj), duhet të regjistrohet në indeksin zyrtar të ankesave dhe kërkesave, për të garantuar gjurmueshmërinë dhe transparencën e komunikimit.

Neni 44

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Personeli i institucionit është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë vendimet dhe udhëzimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim sigurimin e një niveli adekuat të sigurisë gjatë përpunimit, ruajtjes dhe trajtimit të të dhënave personale të të miturve/rinjve, duke përdorur mjetet dhe procedurat e përshtatshme të punës.
2. Të dhënat personale trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe aksesin ndaj tyre e kanë vetëm personat e autorizuar, të cilët kanë nevojë për këto të dhëna për kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.
3. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë të sigurt, në formë fizike dhe elektronike, duke marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksesin e paautorizuar, modifikimin, humbjen ose përhapjen e paautorizuar të tyre.
4. Çdo shkelje e këtij neni, përfshirë aksesin e paautorizuar, zbulimin apo keqpërdorimin e të dhënave personale, konsiderohet shkelje disiplinore dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës së personelit të institucionit.
5. Institucioni garanton trajnimin periodik të personelit në lidhje me përgjegjësitë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatimin e masave të sigurisë.

Neni 45

Përdorimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale lidhur me të miturit/rinjtë duhet të administrohen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore në fuqi. Akses ndaj këtyre të dhënave mund të kenë Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Drejtori i Policisë, Drejtori i institucionit, Shefi i Policisë, Përgjegjësi i Sektorit Ligjor dhe çdo autoritet tjetër kompetent, si dhe personat e autorizuar prej tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës.
2. Personat që, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare, kanë njohuri për të dhënat personale, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe të mos i bëjnë publike këto të dhëna pas përfundimit të detyrës, përveç në rastet e parashikuara me ligj.
3. Të dhënat personale për çdo të mitur/ri ruhen dhe administrohen në regjistra të certifikuar dhe të miratuar nga institucionet kompetente, me qëllim garantimin e integritetit dhe sigurisë së tyre.
4. I mituri/riu ose një person i autorizuar prej tij, ka të drejtë të kërkojë nga Drejtori i Institucionit njohjen me të dhënat personale të tij, duke shpjeguar shkakun dhe llojin e informacionit të kërkuar. Drejtori i Institucionit është përgjegjës që të sigurojë që informacioni i dhënë nuk prek të dhëna personale të personave të tjerë.
5. Në rastet kur kërkesa për informacion vjen nga një person i tretë, dhënia e të dhënave bëhet vetëm pas marrjes së pëlqimit me shkrim të të miturit/riut, përveç në ato raste kur ligji parashikon ndryshe.
6. Për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, përdorimi dhe administrimi i të dhënave personale realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar mbrojtjen e tyre dhe respektimin e privatësisë.

Neni 46

Mjetet Monetare

1. I mituri (mbi 16 vjeç) ose i riu lejohet të ketë një llogari personale bankare, në emrin e tij, të hapur në bashkëpunim ndërmjet IEVP-së dhe një institucioni të licencuar bankar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin bankar dhe të drejtën e pronësisë. Marrëdhënia ndërmjet bankës dhe IEVP-së rregullohet me marrëveshje të posaçme, ku përcaktohet mënyra e depozitimit, tërheqjes dhe përdorimit të fondeve nga i mituri/riu, si dhe procedurat për monitorimin dhe transparencën financiare.
2. Mjetet monetare në këtë llogari mund të përdoren nga i mituri/riu për të blerë sende të lejuara nga kjo rregullore dhe nga rregulloret përkatëse të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në: ushqime, veshmbathje, produkte higjienike dhe sende të tjera personale të autorizuara.
3. I mituri/riu ka të drejtë të transferojë mjete monetare familjes ose të afërmeve, përmes postës ose në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë takimeve familjare, në përputhje me procedurat e miratuara nga IEVP-ja. Tërheqja e këtyre fondeve duhet të bëhet kundrejt dokumentacionit përkatës, të nënshkruar nga i mituri/riu dhe marrësi i shumës, dhe të dokumentohet zyrtarisht nga personeli përkatës i institucionit. Shuma e transferuar zbritet nga llogaria personale bankare e të miturit/riut.
4. Ndalohet rreptësisht mbajtja dhe administrimi i mjeteve monetare në dorë (cash) brenda ambienteve të banimit nga të miturit/rinjtë. Çdo shumë monetare e gjetur në mënyrë të

- kundërligjshme do të trajtohet si send i ndaluar, sekuestrohet menjëherë dhe i kalon kartotekës së institucionit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore dhe Kodin Penal.
5. Në përfundim të qëndrimit në institucion, të miturit/rinjve u kthehen të gjitha fondet monetare të depozituara në llogarinë e tyre personale, përfshirë edhe ato të ndodhura në administrimin e institucionit, përveç rasteve kur ndonjë shumë është objekt i një vendimi gjyqësor ose penalizimi disiplinor të miratuar ligjërisht.
 6. Përdorimi i mjeteve monetare nga të miturit/rinjë për qëllime blerjeje mund të bëhet gjithashtu nëpërmjet njësisë tregtare të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përfshirë platforma online të certifikuara, në përputhje me procedurat e sigurisë dhe transparencës së transaksioneve.

Neni 47

Pagesat dhe shpenzimet

1. Të miturve dhe rinjve u lejohej të mbajnë kartë debiti, në të cilën depozitohen shuma të kufizuara parash, të destinuara për shpenzime ditore të nevojshme.
2. Pagesat për të miturit dhe rinjtë që punojnë brenda institucionit përlllogariten në shumën prej 25% të pagës minimale në shkallë kombëtare.
3. Përdorimi i kartës së pagesës bëhet në përputhje me rregullat e institucionit dhe mbikëqyret nga një komision i përbërë nga:
 - a) Specialisti i sektorit ligjor;
 - b) Specialisti i sektorit të çështjeve shoqërore;
 - c) Një punonjës i sektorit të sigurisë.Komisioni është përgjegjës për kontrollin dhe miratimin e shpenzimeve sipas listës së artikujve të lejuar për blerje.

KAPITULLI VIII

KONTAKTE ME FAMILJEN DHE RRETHIN SHOQËROR

Neni 48

Takimet, me familjen, të afërmit dhe miqtë

1. Me qëllim riintegrimin në shoqëri dhe zvogëlimin e pasojave negative sociale të kufizimit të lirisë, i mituri i dënuar me burgim dhe i mituri i paraburgosur, gëzon të njëjtat të drejta lidhur me garantimin e kontakteve me familjen dhe rrethin shoqëror.
2. Familja dhe rrethi shoqëror, në rast se kërkojnë kontakt me të miturin, paraqesin kërkesë pranë institucionit. Në çdo rast merret pëlqimi i të miturit për realizimin e kontaktit.
3. I mituri ka të drejtë:
 - a. të ketë 8 vizita nga familjarë/rrethi shoqëror në muaj dhe si motivim nxitës 2 vizita shtesë në muaj. Në rast pamundësie të familjarëve dhe rrethit shoqëror për të kryer

- vizitat në orën e parashikuar, organi kompetent bën të mundur garantimin e së drejtës për takim në një kohë të përshtatshme për ta dhe të miturin,
- b. të ketë 4 vizita në vit pranë familjes dhe si motivim vizita shtesë;
 - c. të ketë të paktën 1 vizitë në rastet e problemeve shëndetësore ose emocionale;
 - d. të kryejë jo më pak se 4 thirrje telefonike në javë, pa shpërblim, ku secila prej tyre nuk i kalon 15 minuta, dhe të ketë si motivim nxitës biseda telefonike pa limit me shpenzimet e veta. Në rast të mungesës së të ardhurave, të miturit i sigurohet kjo e drejtë falas nga organi kompetent, pranë të cilit i mituri ndodhet;
 - e. të kryejë 4 videokonferenca në muaj dhe si motivim nxitës 2 videokonferenca shtesë në muaj;
 - f. të marrë letra dhe pako në numër të pa kufizuar;
 - g. të përdorë televizion dhe radio personale;
 - h. të shpenzojë të holla nga llogaria e tij çdo muaj për të blerë ushqime, pajisje për përdorim personal dhe mallra të tjera, në një dyqan në territorin e mjedisit të rehabilitimit.
4. Të miturit që përfiton të drejtat e parashikuara nga ky nen i garantohet e drejta e privatësisë.
 5. Personeli i institucionit e ndihmon të miturin në mbajtjen e kontakteve me familjarët dhe rrethin shoqëror duke iu siguruar atyre mjetet e nevojshme për mbajtjen e këtyre kontakteve.
 6. I mituri ka të drejtën për takime, vizita dhe korrespondencë në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.
 7. I mituri ka të drejtë të bëjë kërkesë verbale për ushtrimin e së drejtës së takimeve, vizitave dhe korrespondencës. Në rast se i mituri nuk bën kërkesë, personeli kryesisht e riinformon për të drejtën për të mbajtur kontakt me familjen dhe rrethin shoqëror.
 8. Vizitat duhet të bëhen në kohë të përshtatshme për të miturit dhe familjarët e tyre.
 9. Korrespondencat dhe vizitat mund të kufizohen dhe mbikëqyren për arsye të kryerjes së hetimeve, ruajtjes së rendit publik, sigurisë, parandalimit të veprave penale, por këto kufizime, përfshi kufizimet e veçanta të caktuara me vendim gjykate ose urdhër prokurori, duhet të lejojnë një nivel minimal kontaktesh.
 10. Informacionet për vdekjen apo sëmundje serioze të familjarëve të afërm, u njoftohen të miturve menjëherë në mënyrë të përshtatshme dhe në prani të psikologut.
 11. Kohëzgjatja e vizitave:
Kohëzgjatja e një takimi të zakonshëm është jo më pak se 1 (një) orë.
Në raste të veçanta dhe kur rrethanat e lejojnë, drejtori i institucionit mund të autorizojë zgjatje të kohës së vizitës, duke marrë parasysh interesin më të mirë të të miturit.
Kur organizimi i institucionit e lejon, i mituri/i riu mund të autorizohet të qëndrojë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Vizitat zhvillohen në mjedise të veçanta nën mbikëqyrjen e personelit të institucionit, jo të dëgjimit, sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.
 12. Në rastin e të paraburgosurve merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.
Takimet zhvillohen çdo ditë nga ora 07:30 deri në 15:00.
Në ditën e shtunë, vizitat lejohen vetëm në raste të veçanta të justifikuara, nga ora 09:00 deri në 13:00.
Regjistrimi për takime bëhet nga ora 07:00 deri në 14:00 të së njëjtës ditë.

13. Raste të veçanta

Drejtori i institucionit mund të japë leje për takime shitesë në rastet kur:

- Ka zhvillime të rëndësishme familjare (p.sh. lindje, vdekje, festa fetare e kombëtare),

14. Personat e tjerë vizitorë

Me miratimin e drejtorit të institucionit, i mituri/riu mund të takohet edhe me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, me një kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë, kur kjo shihet në funksion të mbështetjes psikologjike, edukative apo sociale të tij.

15. Dokumentacioni i vizitorëve

Familjarët, të afërmit dhe çdo vizitor duhet të jenë të pajisur me dokument të vlefshëm identifikimi. Për familjarët, duhet të provohet lidhja familjare me të miturin/riun, përmes dokumentacionit zyrtar.

16. Familjarët dhe të afërmit duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi, i cili provon lidhjen me të miturin/të riun.

17. Takimet kryhen në vendin e caktuar për kryerjen e takimeve të zakonshme.

18. Takimet zhvillohen në mjediset e përcaktuara posaçërisht për këtë qëllim, të ndërtuara për të respektuar dinjitetin dhe privatësinë e të miturit, nën mbikëqyrjen e personelit të trajnuar.

Neni 49

Procedurat për vizitat me anëtarët e familjes ose të afërmit

1. Vizitat e të dënuarit, me anëtarët e familjes, apo të afërmit bëhen me rezervim paraprak në platformën e-albania, ose me planifikim nëpërmjet kërkesës së të dënuarit apo familjarëve.
2. Rezervimi i takimit duhet të kryhet jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë para datës së vizitës. Rezervimin mund ta bëjnë:
 - a) vetë i mituri/riu, përmes shërbimeve të institucionit,
 - b) anëtarët e familjes apo përfaqësues të tyre,
 - c) persona të tjerë të autorizuar nga i mituri/riu, kur kjo është në interesin e tij më të mirë.
3. Me kryerjen e rezervimit të takimit nga i dënuari, anëtari i familjes ose personat e ndryshëm nga anëtarët e familjes, i verifikohet identiteti i personit, bëhet verifikimi i numrit të takimeve në regjistrin e indeksit alfabetik dhe më pas bëhet regjistrimi në regjistrin e takimeve të të dënuarve me familjarët.
4. Më pas, njoftohet përgjegjësi i regjimit të brendshëm, i cili lajmëron të dënuarin mbi ardhjen e familjarëve apo të afërmeve/personave të ndryshëm nga anëtarët e familjes dhe merr masa për organizimin e takimit.
5. Personat vizitorë para takimit i nënshtrohen kontrollit fizik. Këtij kontrolli i nënshtrohet edhe pako që ka me vetë vizitori. Kontrolli i ushqimeve dhe i sendeve, bëhet nga kontrollorët në prezencë të oficerit të informacionit.
6. Shoqërimi i vizitorit nga dhomat e kontrollit deri në dhomën e takimit do të bëhet nga punonjës të rolit bazë në detyrë.
7. Shoqërimi i të dënuarit nga vendi i banimit për në dhomën e takimit bëhet nga punonjësi i rolit bazë, pasi është kontrolluar më parë i dënuari.
8. Në rast se gjatë zhvillimit të takimit konstatohen shkelje të rregullave, pezullohet takimi, veçohet i dënuari dhe largohen familjarët.

9. Çdo familjar pas mbarimit të takimit i nënshtrohet kontrollit para daljes nga ambientet e regjimit të brendshëm.
10. Pas largimit të vizitorit, të dënuarit i bëhet kontrolli nga punonjësi i rolit bazë, në prani të përgjegjësit, i cili e shoqëron pas kontrollit për në dhomën e banimit.
11. Në rast se gjatë zhvillimit të takimit konstatohen shkelje të rregullave:
 - a. Takimi pezullohet menjëherë,
 - b. I mituri/riu veçohet nga vizitorët,
 - c. Familjarët largohen nga ambientet e takimit, dhe ngjarja raportohet zyrtarisht sipas parashikimeve ligjore;
 - d. Veprimi dokumentohet në regjistrat e ngjarjeve.
12. Pas regjistrimit të rezervimit Specialisti i Regjimit të Brendshëm njofton të miturin/riun mbi vizitën dhe merr masat për organizimin e takimit në përputhje me orarin dhe rregullat e institucionit.
13. Para hyrjes në ambientet e takimit, çdo vizitor i nënshtrohet kontrollit fizik, si dhe kontrollit të sendeve të lejuara në përputhje me listën e miratuar nga institucioni.
14. Kontrolli realizohet nga personeli i sigurisë në prani të Specialistit të Drejtimit të Sallës Operative.
15. Pas përfundimit të takimit
 - a) Familjarët ose vizitorët i nënshtrohen një kontrolli fizik përpara daljes nga ambientet e brendshme të institucionit.
 - b) I mituri/riu, pas përfundimit të takimit, kontrollohet nga punonjësi i rolit bazë, në prani të përgjegjësit, dhe më pas shoqërohet drejt dhomës së banimit.

Neni 50

Mbikëqyrja vizuale e takimeve

1. Takimet ndërmjet të miturve/rinjve dhe familjarëve, të afërme apo vizitorëve të tjerë zhvillohen në ambientet e posaçme të përcaktuara nga institucioni, nën mbikëqyrje vizuale të personelit të autorizuar të sigurisë, me qëllim ruajtjen e rendit, sigurisë dhe parandalimin e sjelljeve të paligjshme, duke respektuar privatësinë dhe dinjitetin e të miturit.
2. Në rast shkeljeje:
Në rast se personeli mbikëqyrës konstaton tentativa për shkëmbim të sendeve të ndaluara, ose veprime të tjera që bien ndesh me rregulloren, takimi ndërpritet menjëherë.
Personeli njofton Specialistin e Drejtimit të Sallës Operative, i cili merr masat e mëtejshme në përputhje me procedurat standarde të institucionit, përfshirë kontrollin fizik dhe raportimin zyrtar.
3. Pas përfundimit të kohës së takimit:
 - Personeli mbikëqyrës njofton Specialistin e Drejtimit të Sallës Operative për organizimin e shoqërimit të të miturit/riut drejt regjimit të brendshëm, sipas procedurës së kontrollit dhe përcjelljes;
 - Po ashtu, organizohet dalja dhe shoqërimi i vizitorëve nga ambientet e institucionit, duke u siguruar që të gjitha masat e sigurisë janë respektuar.

Neni 51

Ndalimi i vizitave

Drejtori i Institucionit ka kompetencën të ndalojë përkohësisht vizitat në rastet kur ky ndalim është e justifikuar për arsye sigurie, rregulli institucional, apo mbrojtjeje të të miturit/riut dhe vizitorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 52

Shkaqet e ndalimit të përkohshëm të vizitave

1. Vizitat e vizitorëve ndaj të miturit/riut mund të ndalohen përkohësisht në rastet e mëposhtme:
 - a) Kur ka informacione të besueshme se gjatë takimit ekziston rrezik për sigurinë e institucionit, të miturit/riut ose vizitorëve;
 - b) Në rast të dyshimit të arsyeshëm për planifikim ose kryerje të një vepre penale;
 - c) Kur vizitori përpiqet të fusë sende të ndaluara në institucion;
 - d) Kur takimi mund të dëmtojë shëndetin fizik ose mendor të të miturit/riut apo të vizitorit;
 - e) Në çdo rast tjetër të rrezikshëm për rendin dhe sigurinë institucionale, që kërkon kufizim të përkohshëm të të drejtave për të parandaluar pasoja.
2. Vendimi për ndalim të përkohshëm merret nga Drejtori i Institucionit, i cili përcakton kohëzgjatjen e ndalimit në përputhje me rrethanat e rastit por jo më shumë se 14 ditë.
3. Drejtori është i detyruar të njoftojë me shkrim të miturin/riun dhe vizitorin për arsyet e ndalimit, si dhe të mbajë procesverbal mbi vendimin e marrë.
4. Ndalimi i përkohshëm i vizitave nuk konsiderohet masë disiplinore, por masë sigurie ose parandaluese.

Neni 53

Ndërprerja e përgjithshme e vizitave

1. Drejtori i institucionit pas njoftimit dhe koordinimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, mund të urdhërojë ndërprerjen e përgjithshme të vizitave për të gjithë të miturit/rinjtë, nëse ekziston rrezik serioz për sigurinë e institucionit dhe nuk ka masa alternative më të buta të zbatueshme.
2. Ndërprerja e përgjithshme zgjat për aq kohë sa vazhdon gjendja e rrezikut, dhe duhet të rishikohet periodikisht për proporcionalitet dhe nevojshmëri.
3. Në rast të sëmundjeve ngjitëse ose situatave epidemiologjike, ndalimi i përkohshëm i vizitave bëhet me vendim të përbashkët të Drejtorit të Institucionit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjes.

Neni 54

Bisedat telefonike dhe videokomunikimi

1. Të miturit/rinjtë kanë të drejtë të kryejnë:
 - Jo më pak se 4 (katër) thirrje telefonike në javë, pa pagesë, me kohëzgjatje jo më shumë se 15 minuta për çdo thirrje; (60 minuta në javë)
 - Si masë nxitëse, atyre u mundësohen biseda telefonike shtesë pa limit, me shpenzime personale;

- Katër (4) videokonferenca në muaj, dhe si masë nxitëse, 2 (dy) videokonferenca shtesë në muaj.
2. Në mungesë të të ardhurave ekonomike, institucionet kompetente kanë detyrim të garantojnë të drejtën për kontakt me familjen falas, për të miturit/rinjtë pa mjete ekonomike.
 3. Para aktivizimit të komunikimeve, i mituri/riu duhet të deklarojë paraprakisht numrat e telefonit dhe emrat e poseduesve përkatës tek Përgjegjësi i Sigurisë në regjimin e brendshëm. Numrat e paautorizuar nuk mund të përdoren për komunikim.
 4. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrje vizuale nga personeli përgjegjës, në mënyrë që të garantohet siguria dhe të shmangen abuzimet.
 5. Shërbimi i sigurisë mban regjistër zyrtar për çdo komunikim telefonik, ku dokumentohet:
 - Emri i të miturit/riut;
 - Data dhe ora e thirrjes;
 - Numri i telefonit i përdorur;
 - Emri i personit me të cilin komunikohet.
 6. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose të gjykatës, mund të kufizojë të drejtën për biseda telefonike të të miturit/riut në rast se kjo kërkohet për shkaqe hetimore ose procedurale.
 7. Në rast të abuzimit me rregullat, punonjësi mbikëqyrës ka të drejtë të ndërpresë menjëherë thirrjen ose videokomunikimin, duke njoftuar për shkeljen autoritetet përkatëse të institucionit.

Neni 55

Takimet e të miturve/rinjve me shtetësi të huaj me përfaqësitë diplomatike

1. Të miturit/rinjtë me shtetësi të huaj, që ndodhen në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë, kanë të drejtë të komunikojnë dhe të zhvillojnë takime me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit të tyre. Institucioni është i detyruar të krijojë të gjitha lehtësirat e nevojshme për realizimin e këtij komunikimi, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar.
2. Përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë kanë të drejtë të zhvillojnë takime me shtetasit e tyre të mitur, të paraburgosur apo të dënuar, me njoftim paraprak drejtuar institucionit. Takimet zhvillohen në përputhje me rregullat e sigurisë së institucionit dhe nën kushte që respektojnë dinjitetin dhe privatësinë e të miturit/riut.

KAPITULLI IX

TAKIMET ME GJYQTARË, PROKURORË, AVOKATË DHE INSTITUCIONE TË TJERA

Neni 56

Takimet me prokurorë, avokatë ose oficerë të policisë gjyqësore

1. Gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të autorizuar lejohen të takohen në dhomën e takimit në regjimin e brendshëm për të zhvilluar veprime procedurale me të miturin/riun.
2. Avokatët lejohen të marrin takim me të miturin/riun, kundrejt aktit të përfaqësimit, brenda orarit zyrtar të institucioni.

3. Takimet e gjyqtarit, prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore lejohen në çdo kohë, përveç periudhës së ndaluar për marrjen në pyetje të të miturve gjatë natës (nga ora 22:00 deri në 08:00), sipas nenit 77, pika 3, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
4. Të miturit/rinjtë kanë të drejtë të zhvillojnë takime brenda orarit zyrtar me përfaqësuesin e tyre ligjor, me njoftimin paraprak të institucionit.

Neni 57

Takimet me Avokatin e Popullit

1. Avokati i Popullit ka të drejtë të takohet me të miturit/rinjtë në çdo kohë, pa pasur nevojë për njoftim paraprak ndaj institucionit.
2. Takimet e të miturve/rinjve me Avokatin e Popullit zhvillohen pa mbikëqyrje nga stafi i institucionit.

Neni 58

Takimet me noterët dhe punonjësit e gjendjes civile

1. Të miturit/rinjtë lejohen të takohen me noterin e zgjedhur për kryerjen e veprimeve ligjore gjatë orarit zyrtar, pas marrjes së miratimit nga prokurori për rastet e paraburgosurve.
2. Të miturit/rinjtë shoqërohen në zyrën e gjendjes civile për kryerjen e veprimeve si aplikimi për kartë identiteti, pasaportë, ose për çdo veprim tjetër ligjor që bën pjesë në kompetencën e kësaj zyre, gjatë orarit zyrtar.

KAPITULLI X

RREGULLA MBI SIGURINË

Neni 59

Ndalimi i përdorimit të forcës, mjeteve të tjera

1. Forca dhe mjetet e tjera shtrënguese janë të ndaluara ndaj të miturve/të rinjve në institucion dhe gjatë lëvizjes jashtë institucionit. Zbatimi i masave shtrënguese me qëllim sigurimin e të miturit/riut, mund të aplikohen vetëm në raste përjashtimore/ të jashtëzakonshme, kur të gjitha mjetet e tjera për të parandaluar vetëdëmtimin ose dëmtimin e të tjerëve janë shteruar dhe nuk kanë sjellë rezultat, dhe në qoftë se qëllimi i parashikuar në ligj nuk mund të realizohet me mjete të tjera më pak të dëmshme. Forca duhet të përdoret vetëm si mjet i fundit dhe nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.
2. Për të parandaluar mosbindjen në grup dhe/ose çrregullimin në masë, për të kundërsulmuar dhe për të arrestuar një person të armatosur, mund të përdoren edhe mjete të tjera detyruese, të tilla si: shkop gome, rrjeta izoluese, gaz lotsjellës dhe/ose pompa uji.
3. Masat e forcës duhet të jenë të përshtatshme dhe në minimumin e nevojshëm, duke u përdorur për kohën më të shkurtër të mundshme. Përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik duhet të jetë i përshkallëzuar, proporcional me situatën dhe rrezikun e identifikuar, si dhe i kufizuar në kohë.

4. Ndalohet në mënyrë kategorike përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik për qëllime torturimi, trajtimi çnjerëzor ose degradues, në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
5. Qendra e trajnimeve në DPB është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve trajnimi të personelit për teknikat që minimizojnë përdorimin e forcës dhe nxisin trajtimin human të të paraburgosurve/dënuarve.
6. Ndalohet përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik për periudha më të gjata se sa është e nevojshme, si dhe ndalohet përdorimi i zinxhirëve, hekurave dhe mjeteve të tjera të ngjashme që shkelin dinjitetin njerëzor.
7. Në çdo rast, pas përdorimit të forcës ose mjeteve të kufizimit, të miturve/rinjve i sigurohet menjëherë ndihma mjekësore, e cila dokumentohet në kartelën shëndetësore të tij.
8. Në rastet e vetëdëmtimit, përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik bëhet vetëm pas vlerësimit dhe rekomandimit të mjekut të institucionit, i cili monitoron rregullisht nevojën për vazhdimin e kufizimit. Staf i mjekësor dokumenton rastin në kartelën klinike dhe regjistrin përkatës. Përgjegjësi i sigurisë cakton një punonjës për kujdesin dhe mbikëqyrjen e të mitur/rinjve, i cili duhet të sigurojë ushqim dhe pije në intervale të rregullta.
9. Çdo shkelje e masës së përdorimit të forcës nga ana e personelit trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe sjell përgjegjësi administrative, penale ose disiplinore.
10. Përdorimi i prangave ose këmishëve të forcës lejohet vetëm kur forma më pak intensive të përdorimit të forcës kanë dështuar, për të parandaluar sjelljet e dhunshme, tentativat për arratisje ose vetëdëmtimi. Prangat hiqen gjatë paraqitjes para organeve gjyqësore ose administrative, përveç në rastet kur këto organe vendosin ndryshe. I mitur/riu gjatë përdorimit të prangave duhet të shoqërohet nga dy punonjës sigurie.
11. Çdo përdorim i forcës apo i mjeteve të kufizimit fizik duhet të dokumentohet në mënyrë të detajuar në regjistrat zyrtarë të institucionit, duke përfshirë arsyet, kohëzgjatjen dhe personelin e përfshirë, si dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendor të të miturit/riut.
12. Të gjitha rastet e përdorimit të forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik do të jenë subjekt i një procedure të brendshme të hetimit, për të siguruar që nuk ka pasur abuzim apo keqtrajtim, duke garantuar përgjegjësinë disiplinore dhe ligjore të personelit.
13. Institucioni do të sigurojë trajnime periodike për gjithë personelin në lidhje me të drejtat e njeriut, përdorimin e forcës në mënyrë proporcionale dhe etike, dhe menaxhimin e krizave, duke privilegjuar metodat e paqësore dhe të përshkallëzuara të ndërhyrjes.
14. Përdorimi i forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik duhet të jetë në përputhje të plotë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën kundër Torturës dhe trajtimeve çnjerëzore ose degradues, si dhe me legjislacionin kombëtar dhe standardet më të mira ndërkombëtare për trajtimin e të miturve dhe të burgosurve.

Neni 60

Raste përjashtimore të cilat mund të aplikohen si mjet i fundit

1. Përdorimi i forcës fizike ndaj të mitur/riut nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur është inevitues për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosurit tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin ose në rast të rezistencës aktive

ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm. Forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk duhet të ketë karakter ndëshkues.

2. Masa e forcës së përdorur duhet të jetë në minimumin e mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik kryhet në mënyrë të përshkallëzuar, në proporcion me situatën dhe nivelin e rrezikut, dhe duhet të jetë i kufizuar në kohë.
3. Në çdo rast, ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues. Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit nuk duhet të tejkalojë kufizimet e vendosura në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
4. Ndalohet përdorimi i prangave apo këmbishëve të forcës, me përjashtim të rasteve kur forma të tjera të përdorimit të forcës më pak intensive kanë dështuar. Prangat mund të përdoren nëse janë të domosdoshme për të parandaluar një sjellje të dhunshme ose kur i burgosuri bën përpjekje për t'u arratisur. Prangat hiqen kur i mituri/riu shfaqet para një organi gjyqësor apo administrativ, me përjashtim të rastit kur ky autoritet vendos ndryshe. I mitur/riu vendoset në mes të 2 (dy punonjësve) të sigurisë.
5. Në rast të dëmtimit fizik, të miturve/rinjve iu jepet menjëherë ndihma mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën shëndetësore.
6. Në rastet e vetëdëmtimit të të mitur/rinjve institucioni përdor mjete të veçanta të kufizimit fizik. Për vendosjen apo kohëzgjatjen e kufizimit fizik merret në çdo rast mendimi i mjekut të institucionit. Mjeku i institucionit vlerëson rregullisht nëse përdorimi i mjeteve kufizuese duhet të vazhdojë ose jo. Staf i mjekësor bën vlerësimin e riskut të të miturve/rinjve përcakton kohëzgjatjen e kufizimit dhe dokumenton rastin në kartelën klinike dhe në regjistrin e kufizimit fizik. Përgjegjësi i Sektorit të Policisë, cakton një punonjës përgjegjës për kujdesin dhe mbikëqyrjen e të burgosurit. I mitur/riu duhet të marrë ushqim dhe pije në intervale të rregullta kohore.
7. Në rastin e tejkalimit të masës së përdorimit të forcës nga ana e personelit të institucionit, ndaj tyre veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 61

Rregulla mbi sigurinë gjatë shoqërimit të miturit/rinjtë

1. Shoqërimi i të miturit bëhet kryesisht gjatë ditës, në oraret e përcaktuara (gjatë dimrit ora 07:00-16:00, ndërsa gjatë stinës së verës ora 05:00-19:00).
2. Shoqërimi i të miturit në raste të veçanta mund të bëhet edhe natën, kur ka urgjencë ose të emergjencës mjekësore me masa të përforcuara sigurie shtesë sigurie shoqëruar me të drejtorit të Institucionit dhe me praninë e personelit kompetent për mbikëqyrjen e tyre.
3. Gjatë shoqërimit, i mituri duhet të mbahet në mënyrë që të ruhet dinjiteti dhe siguria e tij, duke shmangur çdo trajtim degradues apo stresues.
4. I mituri mbahet i ulur, me duar përpara dhe me pranga kur prangosja është e domosdoshme, për të parandaluar arratisjen ose për të mbrojtur sigurinë e personave të tjerë apo të vetë të miturit/riut.

Neni 62

Kontrolli i personelit që shoqëron miturit/rinjtë

1. Kontrolli i personelit kryhet nga punonjës të policisë në momentin e hyrjes në institucion, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e dinjitetit dhe privatësisë.
2. Kontrolli personal i personelit kryhet nga punonjës të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, në praninë e jo më pak se dy punonjësve, në mënyrë që të shmangë mundësinë e kontaktit vizual nga personeli i gjinisë tjetër dhe duke marrë parasysh moshën e të miturit e natyrën e detyrës.
3. Në rastet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që personeli fsheh në trup sende të ndaluara, zbatohen procedurat e kontrollit, harton një raport ku jepen arsyet e kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij.
4. Në të gjitha rastet e kontroleve bëhet raportim i detajuar me respektimin e të drejtave të të miturit dhe personelit.
5. Në rastin e të miturve, kontrolli i personelit bëhet në mënyrë që të ruhet dinjiteti i tyre dhe të shmangen situatat që mund të ndikojnë negativisht në gjendjen psikologjike dhe emocionale të të miturit.
6. Personeli që shoqëron të miturin duhet të jetë i trajnuar për trajtimin e veçantë të të miturve dhe të respektojë rregullat e privatësisë gjatë kryerjes së kontrollit.

Neni 63

Procedurat për kufizimin e të drejtave në situata emergjente

1. Të drejtat miturve/rinjve mund të kufizohen me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë për kufizimin e të drejtave duhet të jetë i arsyetuar dhe i shkruar, duke përshkruar arsyet dhe kohëzgjatjen e kufizimit.
2. Kufizimet e vendosura në situata emergjente duhet të jenë proporcionale dhe të zbatohen për periudhën më të shkurtër të mundshme. Në çdo rast, kohëzgjatja e kufizimit të të drejtave vendoset në atë masë dhe për aq kohë sa përlicjet nga rrethanat që diktojnë këtë kufizim dhe nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e rastit për shkak të të cilit vendoset kufizimi sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Institucioni duhet të informojë menjëherë të gjithë personat e prekur nga kufizimi i të drejtave dhe të sigurojë që këto kufizime të mos cenojnë të drejtat themelore të njeriut. Pas përfundimit të situatës emergjente, të drejtat e kufizuara rikthehen menjëherë në gjendjen e mëparshme.
4. Rregullat më të detajuara dhe procedurat për kufizimin në grup të të drejtave dhe kaliminnë gatishmëri përcaktohen në legjislacionin në fuqi për Policinë e Burgjeve.
5. Kufizimi në grup i të drejtave sipas këtij neni, nuk cënon të drejtën e të mitur/ri për të komunikuar me mbrojtësin e tij dhe për të paraqitur ankesa në përputhje me parashikimet e ligjit për Policinë e Burgjeve.
6. Çdo urdhër të Ministrit të Drejtësisë për kufizim të të drejtave ose në rastet urgjente nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, mund të rishikohet nga një organ i pavarur brenda 48 orëve nga vendosja e tij.

Neni 64

Situatat emergjente dhe kalimi në gatishmëri

1. Situata emergjente janë situata të caktuara që krijohen dhe që kërkojnë veprim të menjëhershëm, si arratisjet ose tentativë arratisje, kryengritje, revoltat dhe prishje të rendit, zjarret dhe dukuritë natyrore, duke përfshirë tërmetet, përmbytjet apo stuhitë shkatërruese.

2. Kufizimi në grup i të drejtave, në situata emergjente dhe në rastet e kalimit në gadishmëri, bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve dhe ligjit mbi Policinë e Burgjeve, si dhe kësaj rregulloreje.
3. Drejtori i institucionit me stafin e sigurisë merr masat e nevojshme në bazë të “planit i instruktimit të emergjencave civile në institucion”, “planit i instruktimit në institucion për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat civile” pranë njësisë vendore dhe “planit i bashkëveprimit për kordinimin e veprimeve midis IEVP dhe komisariatit të policisë” në nivel bashkie ose qarku.

Neni 65

Masat në rastet e situatave emergjente

1. Llojet e masave në rastet e situatave emergjente janë:
 - a) rritja e masave të nivelit të sigurisë në institucion, në përputhje me vlerësimin e rrezikut dhe nivelin e klasifikimit të gatishmërisë, sipas urdhrit të ministrit të Drejtësisë;
 - b) transferimi i përkohshëm i të riut në një institucion më të përshtatshëm të kryerjes së dënimit;
 - c) kufizimi dhe pezullimi i aktiviteteve në institucion deri në përfundimin e situatës emergjente.

Neni 66

Kontrolli në mjediset e dhomave

Kontrolli në mjediset dhe dhomat ku qëndrojnë të miturit/rinjte kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga personeli i specializuar në prani të të miturit/riut.

Neni 67

Kontrolli personal i vizitorëve dhe personelit

1. Kontrolli personal zbatohet edhe për subjektet që kanë statusin e vizitorit dhe për personelin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në legjislacionin fuqi dhe në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.
2. Personat që kanë të drejtë të realizojnë takim apo vizitë me të miturit/rinjte i nënshtrohen kontrollit nga ana e Policisë së Burgjeve fizikisht apo me mjete teknike të kontrollit. Personeli që bën kontrollin duhet të jetë i së njëjtës gjini me atë të personit që kontrollohet.
3. Kontrollat e vizitorëve të të miturve/rinjve bëhen duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e tyre dhe pa dëmtuar sendet që ata posedojnë.
4. Pasi verifikohet identiteti i personit që do të takojë të miturit/rinjte dhe autorizimi për të hyrë në institucion, vijohet me kontrollin e tij duke i shpjeguar paraprakisht në çdo rast me gjuhë të kuptueshme arsyet e kontrollit personal, si dhe ndalimin e futjes së sendeve në institucion.
5. Kontrolli i vizitorëve bëhet në ambiente të veçanta, në të cilën lejohet të futet vetëm vizitori dhe punonjësit e Policisë së Burgjeve. Kur vizitor është edhe 1 (një) person i mitur kontrolli bëhet në praninë e prindit apo kujdestarit të tij.
6. Në rastin e një dyshimi të arsyeshëm për posedim të sendeve të ndaluara kryhet kontroll i imtësishëm, me urdhër të drejtorit institucionit, nga stafi mjeksor në mjedise të pa ekspozuara dhe në çdo rast në praninë e jo më pak se 2 (dy) punonjësve.

Neni 68

Kontrolli

Punonjësi i Policisë së Burgjeve ushtron kontroll në mjedise, si dhe ndaj të mitur/rinjve; personave që hyjnë brenda perimetrit të sigurisë dhe kanë statusin e vizitorit; sendeve personale dhe personelit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

1. Kontrolli personal kryhet nga punonjës të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar, në praninë e jo më pak se dy punonjësve dhe në mënyrë që shmang mundësinë e shikimit nga punonjësi i gjinisë tjetër.
2. Kontrolli bëhet në proporcion me nevojën, në respektimin e dinjitetit të personit që kontrollohet, të besimit e veçori të tjera të tij dhe sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
3. Në çdo rast ndalohet kontrolli intim ndaj personave që i nënshtrohen kontrollit nga ana e punonjësit të Policisë së Burgjeve.
4. Personi që kontrollohet duhet të jetë i pranishëm gjatë kontrollit të sendeve personale të tij, me përjashtim të rasteve kur përdoren mjetet teknike të kontrollit ose prania e personit përbën rrezik për personelin që ushtron kontrollin. Kontrolli personal dhe i sendeve personale të personit mund të bëhet edhe me mjete teknike të kontrollit.
5. Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe të kontroleve në mjedise, punonjësi i policisë së institucionit harton një raport, ku jepen arsyet e hyrjes, të kryerjes së kontrollit dhe rezultatet e tij.
6. Rregullat e hollësishme për rastet, llojin dhe mënyrën e ushtrimit të kontroleve parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve neni 68 dhe 69 i kësaj rregulloreje.

Neni 69

Detyrimi i përgjegjshmërisë dhe i refuzimit të urdhërave të paligjshëm

1. Punonjësi i Policisë mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi ose mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Punonjësi i Policisë ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët sipas linjës së komandimit, sipas ligjit, Udhëzimit mbi “Përshkrimi i detyrave të policisë së burgjeve dhe skema e vendosjes së vend shërbimeve në IEVP Kavajë” dhe rregullores së brendshme të institucionit.
3. Në rast se punonjësi i policisë e vlerëson urdhërin verbal të paligjshëm, ai kërkon nga eprori i tij që urdhëri të jepet edhe me shkrim.
4. Në rast se Punonjësi i Policisë, edhe pas zbatimit të procedurës së parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nga komunikimi i urdhërit deri në dhënien me shkrim të tij, vazhdon të ketë dyshime për paligjshmërinë e urdhërit të eprorit, ai nuk e zbaton atë, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhërin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.
5. Punonjësi i Policisë ka detyrimin të vërë në dijeni, pa vonesë, organet përkatëse të kontrollit të ligjshmërisë së veprimtarisë të Policisë së Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, nëse urdhëri i dhënë me shkrim, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, është në vlerësimin e tij i paligjshëm.
6. Në çdo rast, mosrespektimi i detyrimeve dhe i procedurave, që burojnë nga ky nen, nga punonjësi që ka dhënë, konfirmuar apo zbatuar urdhërin, në rast se nuk përbën vepër penale, përbën shkak për fillimin e hetimit administrative nga institucioni.

KAPITULLI XI

REHABILITIMI, PËRGATITJA PËR LIRIM DHE RIINTEGRIM

Neni 70

Programet rehabilituese

1. Programet e rehabilitimit kanë për qëllim aftësimin social të të miturve/rinjve përmes përvetësimit të njohurive të reja dhe zhvillimit të aftësive pro-sociale, duke synuar minimizimin e riskut të sigurisë dhe parandalimin e recidivizmit.
2. Programet rehabilituese përfshijnë:
 - a) programe për aftësitë e jetës;
 - b) programe terapeutike për shëndetin mendor;
 - c) programe arsimore;
 - d) formim profesional
 - e) punësim
 - f) programe të tjera mbështetëse të përshtatshme.
3. Pjesëmarrja në programet rehabilituese bëhet pas një vlerësimi të kujdesshëm të riskut dhe nevojave kriminogjene të të miturit/riut.
4. Administrata zhvillon një vlerësim të detajuar për të përcaktuar nëse i mituri/riu paraqet rrezik për vetëdëmtim, për të tjerë të mitur/rinj, personelin e institucionit, vizitorët apo komunitetin, si dhe për mundësinë e arratisjes ose kryerjes së veprave penale të rënda gjatë lejes apo pas lirimit.
5. Vlerësimi fillestar i riskut dhe i nevojave kryhet nga personel i trajnuar dhe, kur është e mundur, në qendra të specializuara vlerësimi.
6. Trajtimi i grupeve të veçanta të të miturve/rinjve realizohet nga personel i specializuar dhe i trajnuar për këto kategori.

Neni 71

Individualizimi i trajtimit

1. Sektori çështjeve shoqërore vlerëson personalitetin e të miturve/rinjve me qëllim identifikimin e nevojave psikologjike dhe sociale, aftësinë dhe vullnetin për punë dhe formim profesional. Bazuar në vëzhgimet dhe të dhënat personale, familjare, shoqërore dhe masën e dënimit, personeli i sektorit të çështjeve shoqërore harton planin e ri-integrimit për çdo të mitur/ri dhe programin individual të trajtimit për grupe të veçanta. Ky plan përgatitet nga një grup specialistësh, i përbërë nga psikologë dhe punonjës socialë. Plani i ri-integrimit përfshin këshillim, terapi, psiko-edukim, arsimim, formim profesional, aktivitete social-edukative, kulturore, sportive, fetare, punësim, shërbim bibliotekar, dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm.
2. Punonjësi i sektorit të çështjeve shoqërore evidenton të dhënat e grumbulluara nga vëzhgimi, trajtimi individual, dhe nga sjellja gjatë gjithë periudhës së burgimit, të cilat përfshihen në dosjen psiko-sociale të të miturit/riut.
3. Punonjësi i shërbimit social diskuton me të miturin/riun planin e ri-integrimit dhe programin individual të trajtimit, duke bërë rivlerësimin dhe ndryshimet e nevojshme në përputhje me ecurinë e trajtimit.
4. Trajtimi psiko-social i veçantë i kushtohet të miturve/rinjve me çrregullime të shëndetit mendor, personave me aftësi të kufizuar, orientim seksual të ndryshëm, sëmundje kronike ose varësi nga

droga, personave të dënuar me dënime afatgjata, minoriteteve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

5. Planifikimi individual për menaxhimin e dënimit afatgjatë ka si qëllim zhvillimin progresiv, i bazuar në një model pro-social në sistemin e burgjeve.
6. Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit, me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.
7. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë nxitet dhe mbështetet nga administrata në realizimin e programit të trajtimit.

Neni 72

Prindërimi në distancë

1. Prindërimi në distancë ka për qëllim forcimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të të miturve/rinjve me familjen, si dhe përgatitjen e tyre për ri-integrim në shoqëri pas lirit.
2. Në institucion krijohen mjedise të veçanta, të përshtatura për zhvillimin e këtij programi, ku të miturit/rinj të kanë mundësi të realizojnë takime të organizuara me familjarët e tyre në kushte dinjitoze dhe mbikëqyren nga stafi për të garantuar sigurinë dhe privatësinë.
3. Programi i prindërimit në distancë përfshin aktivitete të ndryshme, si biseda, konsultime psikologjike dhe aktivitete edukative, të cilat ndihmojnë në forcimin e lidhjes familjare dhe përgatitjen për një ri-integrim të suksesshëm.
4. Koordinimi i këtij programi bëhet nga personeli social dhe psikologjik i institucionit, në bashkëpunim me familjet dhe me mbështetjen e organizatave të specializuara, kur është e nevojshme.

Neni 73

Pjesëmarrja në aktivitete dhe veprimtari edukative, kulturore, çlodhëse, sportive dhe fetare

1. Procesi i rehabilitimit përfshin programe trajtimi në grup për të miturit/rinj, duke u ofruar mundësi për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të institucionit, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe nxisin interesin për arsimim, formim profesional, veprimtari kulturore, edukative, çlodhëse, sportive dhe spirituale.
2. Administrata bashkëpunon me institucione të tjera, organizata jofitimprurëse dhe organizata fetare për organizimin e veprimtarive kulturore, krijuese dhe sportive, brenda dhe jashtë institucionit.
3. Institucioni organizon veprimtari me karakter social çdo muaj. Data dhe orari i këtyre veprimtarive përcaktohen nga Drejtori i institucionit. Pjesëmarrja në këto veprimtari është vullnetare.
4. Të vetmet lojëra të lejuara janë ato që nuk rrezikojnë rendin, rregullin dhe sigurinë në dhoma dhe në të gjithë institucionin. Aktivitetet sportive lejohen vetëm në ambiente të përcaktuara për këtë qëllim.
5. Përdorimi i dhomave dhe ambienteve çlodhëse bëhet me urdhër të Drejtorit të institucionit.
6. Mbajtja dhe përdorimi i materialeve për punë artizanale lejohet vetëm pas marrjes së lejes dhe me kusht që të mos cënohet rregulli dhe siguria në institucion.

7. Zhvillimi i aktiviteteve sportive jashtë programit zyrtar të institucionit bëhet vetëm me lejen e Drejtorit të Institucionit.
8. Të miturit/rinjtë nuk detyrohen të marrin pjesë në aktivitetet fetare pa dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë.

Neni 74

Arsimimi 9-vjeçar dhe i mesëm

1. Të miturve dhe të rinjve u sigurohet arsimi bazë i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm. Regjistrimi i nxënësve në shkollë bëhet sipas procedurave të përcaktuara në marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit për zhvillimin e procesit mësimor në IEVP Kavajë, brenda afateve të caktuara.
2. Procesi arsimor në mjediset e paraburgimit dhe burgimit për të mitur dhe të rinj duhet të jetë në përputhje me standardet e arsimit në Republikën e Shqipërisë.
3. Dokumentet që vërtetojnë shkollimin e kryer nga të miturit dhe të rinj gjatë periudhës së pandehjes ose vuajtjes së dënimit, nuk duhet të përmbajnë të dhëna që mund të identifikojnë personin si ish-i dënuar ose të tregojnë një dënim të mëparshëm.
4. Për të dënuarit e mitur që kanë vështirësi në të mësuar ose për të miturit dhe të rinjtë që nuk kanë ndjekur shkollën, organizohen programe arsimore të veçanta dhe individuale.
5. Procesi arsimor në IEVP Kavajë rregullohet me Urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Arsimit.
6. Sektori i Çështjeve Shoqërore mbështet zhvillimin e procesit arsimor, motivon të miturit për ndjekjen e arsimit dhe monitoron sjelljen e tyre.
7. Sektori i Policisë krijon kushtet optimale për zhvillimin e procesit arsimor, duke ruajtur rregullin dhe disiplinën, duke zbatuar orarin e mësimi dhe duke mbështetur edukatorët dhe mësuesit në zbatimin e masave pedagogjike.
8. Institucioni mbulon shpenzimet për arsimin e të miturve dhe të rinjve që studiojnë në nivelet 9-vjeçar dhe të mesëm.
9. Organizimi dhe menaxhimi i procesit mësimor përcaktohen me rregullore të fillimit të vitit shkollor, e cila miratohet nga Drejtori i Institucionit.

Neni 75

Kurset profesionale

1. Drejtoria e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale nxit dhe krijon kushtet për zhvillimin e kurseve të formimit profesional brenda dhe jashtë institucionit. Trajnimi realizohet nga profesionistë të specializuar, sipas marrëveshjeve të përbashkëta me Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.
2. Të miturit dhe të rinjtë që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të cilët nuk kuptojnë ose zotërojnë në mënyrë të pamjaftueshme gjuhën shqipe, si dhe të dënuarit e huaj, u mundësohen materiale të shkruara në gjuhën e tyre ose në një gjuhë të kuptueshme për ta.
3. I mituri/riu inkurajohet të ndjekë kurset e formimit profesional për zhvillimin e aftësive të nevojshme.
4. Të miturve dhe të rinjve u krijohen mundësi për trajnim profesional në përputhje me interesat dhe prirjet e tyre, duke synuar ndihmën për punësim pas largimit nga institucioni.

Neni 76

Puna e të miturve/rinjve

1. Puna që kryhet nga i mituri/riu në institucion shpërblehet në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Çdo aktivitet pune brenda institucionit është i formalizuar dhe i ligjshëm, duke respektuar të drejtat e të miturve për kompensim të drejtë. Kohëzgjatja e punës dhe e edukimit të të miturit nuk duhet të kalojë 8 orë në ditë.
2. Të miturit/rinj të kanë të drejtë të marrin shpërblim mujor në përpjesëtim me sasinë dhe cilësinë e punës, duke garantuar parimin e drejtësisë dhe proporcionalitetit në shpërblim.
3. Punësimi ka një funksion të rëndësishëm ri-integrues dhe zhvillues: sigurimi dhe zhvillimi i aftësive profesionale dhe njohurive, përgatitja për jetën në shoqëri pas përfundimit të dënimit. Kjo është në përputhje me parimet e rehabilitimit dhe rikthimit social të të miturve, si pjesë e drejtësisë riparative.
4. Aktet ligjore dhe nënligjore që mbrojnë shëndetin, sigurinë në punë, mirëqenien sociale dhe rregullat për marrëdhëniet e punës zbatohen plotësisht për të miturit/rinj të, me përjashtim të ushtrimit të së drejtës për grevë dhe pjesëmarrjes në sindikata, duke respektuar specifikat ligjore për këtë kategori të veçantë.
5. Të miturit që angazhohen në punë duhet të pajisen me materialet dhe pajisjet e nevojshme sipas normave të caktuara, të cilat menaxhohen në mënyrë të kontrolluar nga magazinieri i burgut dhe specialisti i informacionit për materialet e ndaluara. Kjo është një masë sigurie që synon mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e keqpërdorimeve.
6. I mituri/riu ka detyrimin ligjor dhe etik të sillet me përgjegjësi dhe profesionalizëm ndaj detyrave të punës, duke respektuar urdhrat dhe duke ruajtur bazën materiale. Për dëmtime apo humbje që ndodhin nga pakujdesia ose qëllimisht, ekziston detyrimi për kompensim, duke synuar përgjegjësinë personale dhe disiplinën.
7. Personeli ka përgjegjësinë aktive për të nxitur, motivuar dhe mbështetur të miturit për punësim dhe vetëpunësim, duke vlerësuar aftësitë dhe prirjet e tyre profesionale. Kjo nënkupton një qasje individuale dhe zhvillimore për çdo të mitur.
8. Në rast të punësimit jashtë institucionit, bëhet një vlerësim i detajuar i kushteve të punës, rrezikut për sigurinë e publikut, gatishmërisë së punëdhënësit dhe kushteve të transportit. Kjo masë garanton sigurinë dhe përshtatshmërinë e punësimit të të miturit jashtë mjedisit të burgut.

Neni 77

Mjetet e punës që futen në regjimin e brendshëm të të miturve/rinjve

1. Mjetet e punës lejohen të futen në ambientet e banimit vetëm kur është absolutisht e nevojshme. Kjo bëhet vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit dhe me një plan të detajuar detyrash dhe përgjegjësish për përdorimin e tyre.
2. Mjetet dhe materialet që futen në ambientet e banimit inventarizohen në një regjistër standard, ku përshkruhet emri i tyre, sasia dhe detaje të tjera të rëndësishme. Kontrollohen me kujdes sipas procedurave dhe më pas dorëzohen me procesverbal personit të autorizuar për përdorimin dhe punonjësit të sigurisë.

3. Pas përfundimit të punës, mjetet dhe materialet dalin nga ambientet e banimit vetëm pas kontrollit dhe inventarizimit, sipas procesverbalit të dorëzimit.
4. Mjetet e punës ruhen në ambiente të sigurta jashtë ambientit të banimit, janë të inventarizuara, të emërtuara dhe të klasifikuara sipas nivelit të rrezikut që paraqesin.
5. Procedurat e kontrollit, marrjes dhe dorëzimit të mjeteve zbatohen edhe për mjetet dhe materialet që përdorin të miturit në punë artizanale apo aktiviteteve të tjera brenda institucionit.
6. Në rast se ndonjë mjet pune humbet, përgjegjësi i sigurisë organizon menjëherë një kontroll të plotë për gjetjen e tij.

Neni 78

Plotësimi i nevojave fetare

1. Të miturit/rinj të kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete fetare, si lutje, falje, festa dhe ngjarje të tjera, por nuk lejohet që ata të drejtojnë këto aktivitete.
2. Drejtimi i faljeve, lutjeve dhe aktiviteteve fetare bëhet vetëm nga përfaqësues të Komiteteve Fetare, të autorizuar dhe të verifikuar nga strukturat e sigurisë së burgut.
3. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve fetare, nuk lejohet bashkimi i të dënuarve me të dënuarit që kanë shfaqur sjellje të dhunshme dhe paraqesin rrezik për të tjerët.
4. Në rast se nuk ekziston ambient i posaçëm për nevojat fetare, të miturit/rinj të mund të kryejnë ceremonitë fetare në dhomat e tyre, duke respektuar rregullat e rendit dhe sigurisë në institucion.
5. Gjatë aktiviteteve fetare duhet të ruhet rendi, disiplina dhe siguria në institucion, si dhe të mos çënohet ndjenja fetare apo kombëtare e të miturve/rinjve.
6. Pjesëmarrja në aktivitetet fetare është plotësisht vullnetare dhe të miturit/rinj të nuk mund të detyrohen të marrin pjesë.

Neni 79

Shërbimi bibliotekor

1. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë nxitet dhe inkurajohet leximi i librave përmes funksionimit të shërbimit të bibliotekës.
2. Organizimi dhe mbikëqyrja e bibliotekës bëhet nga Sektori i Çështjeve Shoqërore, i cili kujdeset për mirëmbajtjen, pasurimin dhe shpërndarjen e literaturës.
3. Përzgjedhja e literaturës bëhet duke respektuar nivelin shkencor, kulturor dhe artistik të materialeve.
4. Favorizohet leximi pa kufizim i botimeve dhe përdorimi i mjeteve të tjera informative të bibliotekës.
5. Biblioteka duhet të përmbajë literaturë që trajton të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, legjisllacionin penal dhe procedurat e trajtimit të të miturve/rinjve.
6. Çdo i mitur/ri ka të drejtë të anëtarësohet në bibliotekë dhe tërheqja e librave bëhet me kartelën personale.
7. Në bibliotekë mund të lexohet literatura dhe shtypi i përditshëm nga të miturit/rinj të.

8. Lexuesi mund të marrë deri në 3 libra njëherësh, me afat kthimi 2 (dy) javë nga dita e marrjes.
9. Afati i kthimit mund të shtyhet me kërkesë të lexuesit në bibliotekë.
10. Librat duhet të ruhen me kujdes; lexuesi duhet të kontrollojë librin para marrjes dhe përgjigjet për dëmtimet ose humbjet.
11. Nuk lejohet shkëmbimi i librave midis të miturve/rinjve dhe marrja e tyre në vendin e punës.
12. Në rast lirimesh ose transferimesh, i mituri/riu është i detyruar të dorëzojë librat personalisht në bibliotekë para largimit nga institucioni.

Neni 80

Pajisjet e palestrave si aktivitete fizike

1. Të gjitha mjetet e forcës në ambientet e palestrave (palestrave sportive) regjistrohen në një inventar si pjesë e masave të sigurisë. Gjendja fizike e këtyre mjeteve kontrollohet rregullisht sipas inventarit.
2. Hyrja dhe dalja e të dënuarve ose të paraburgosurve në palestrat sportive bëhet vetëm pas kontrollit fizik të personave.
3. Aktivitetet në palestrat sportive mbikëqyren nga punonjës të policisë për të siguruar rendin dhe sigurinë.
4. Të miturit në konflikt me ligjin i krijohet mundësia për ecje, aktivitete sportive dhe ripërtëritëse të përditshme, me anë të përdorimit të pajisjeve të duhura sportive në një hapësirë të përshtatshme.
5. Të miturve, përfshirë dhe të miturit me aftësi të kufizuara, u sigurohen programe trajnuese fizike dhe ripërtëritëse.

Neni 81

Përgatitja për liri dhe ri-integrim

1. Plan individual i trajtimit dhe përgatitjes për liri hartohet jo më vonë se 6 muaj para lirimit të të miturit/riut, duke evidentuar të gjitha nevojat e tij dhe duke u bazuar në interesat më të larta të tij.
2. Administrata e IEVP harton dhe përditëson planin e ri-integrimit, duke bashkëpunuar me të miturin, familjen dhe strukturat për mbrojtjen e tij, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (neni 133).
3. Për çdo i mitur/ri të liruar hartohet plan i veçantë që adreson nevojat, rreziqet, rekomandimet për ndërhyrje dhe mbështetje pas lirimit, duke synuar parandalimin e veprave penale të reja dhe përfshirjen në shërbime komunitare.
4. Administrata siguron që i mituri/riu të kuptojë përmbajtjen e planit.
5. Pas kryerjes së dy të tretave të dënimit, por jo më pak se tre muaj para mbarimit të tij, administrata:
 - a) informon të miturin, përfaqësuesin ligjor dhe institucionet përkatëse;
 - b) ofron mbështetje psikologjike dhe arsimore për përgatitjen për lirim;
 - c) mundëson vizita të shkurtra në shtëpi;

- d) përgatit dokumentacion për situatën sociale të të miturit për të mbështetur ri-integrimin;
 - e) jep informacion të qartë dhe të kuptueshëm për mbështetjen pas lirimit;
 - f) bashkëpunon me organet shëndetësore në vendbanim për zbatimin e planit të ri-integrimit.
6. Bashkëpunimi me institucione dhe agjenci të ndryshme është kyç për ri-integrimin e suksesshëm të të miturit në shoqëri.
 7. Administrata e IEVP synon të përgatisë të miturin/riun për rehabilitimin dhe lirin që në fillim të dënimit.
 8. Për këtë qëllim, personeli bashkëpunon me autoritetet vendore, QPKMR, shoqata dhe subjekte të tjera të interesuara, si Caritas Albania dhe Shërbimi i Provës.

Neni 82

Angazhimi i Sektorit të Çështjeve Shoqërore

Stafi psiko-social dhe mbështetës i institucionit angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të motivuar të miturit dhe të rinjtë drejt zhvillimit të sjelljeve pozitive dhe edukuese, duke përfshirë këtu kujdesin ndaj vetes, ruajtjen e higjienës personale, si dhe përvetësimin e sjelljeve etike, bashkëpunuese dhe sociale. Motivimi realizohet përmes mbështetjes emocionale, vlerësimit pozitiv të përparimit personal dhe përfshirjes në aktivitete edukative, kulturore dhe sociale.

Neni 83

Format e motivimit nxitës për të miturin e dënuar

1. Kur i mituri dhe i riu shfaq sjellje shembullore dhe angazhohet në mënyrë të vazhdueshme dhe proaktive në programet edukative dhe aktivitetet e zhvilluara në institucionin e vuajtjes së dënimit, institucioni mund të aplikojë ndaj tij format e mëposhtme të motivimit nxitës:
 - a) Dhënie e një certifikate mirënjohjeje;
 - b) Dhënie e së drejtës për një vizitë shtesë me persona të autorizuar;
 - c) Dhënie e së drejtës për një bisedë shtesë nëpërmjet video-lidhjes;
 - d) Dhënie e së drejtës për një telefonatë shtesë;
 - e) Pranimi i sendeve, të cilat nuk janë të ndaluara për t'u marrë nga të dënuarit në vendin e vuajtjes së dënimit për të mitur;
 - f) Dhënie e së drejtës për të përdorur kompjuter (në kushte të mbikëqyrura dhe për qëllime edukimi);
 - g) Plotësimi i një dëshire individuale të arsyeshme, që çmohet e mundshme dhe proporcionale me gjendjen e tij dhe kapacitetet e institucionit.
2. Llojet, natyra dhe kushtet për pranim të sendeve të lejuara, në kuptim të shkronjës "f", pika 1, të këtij neni, përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe në aktet e tjera përkatëse nënligjore.

KAPITULLI XII

DISIPLINA E TË MITURVE/RINJVE

Neni 84

Komisioni i vlerësimit të sjelljes

1. Komisioni i vlerësimit të sjelljes së të miturve/rinjve ngrihet me urdhër të Drejtorit të Institucionit.
2. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, organi që administron procesin e trajton të miturin me kujdes dhe vëmendje të veçantë.
3. Në çdo vendimmarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: moshë, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual.

Neni 85

Vlerësimi i sjelljes së të miturve/rinjve

1. Komisioni i vlerësimit të sjelljes harton vlerësimin për sjelljen e çdo të mituri/riu në mënyrë periodike dhe sistematike, sipas këtyre rregullave:
 - a) Vlerësimi kryhet çdo 6 muaj dhe protokollohet zyrtarisht; ky dokument ruhet si në dosjen psiko-sociale, ashtu edhe në dosjen penale të të miturit/riut
 - b) Për seancat gjyqësore që kanë si objekt uljen e dënimit, në vlerësim përfshihen dhe pasqyrohen të gjitha masat disiplinore që janë dhënë ndaj të miturit gjatë vitit të fundit të vuajtjes së dënimit;
 - c) Për seancat gjyqësore që kanë për qëllim lirimin me kusht ose ndryshimin e klasifikimit të sigurisë, në vlerësim pasqyrohen të gjitha masat disiplinore të dy viteve të fundit të vuajtjes së dënimit.
2. Çdo herë që një i ri transferohet nga një institucion në tjetrin, transferimi shoqërohet patjetër me vlerësimin e sjelljes, i cili administrohet dhe ruhet në dosjen personale të të miturit/riut.
3. Vlerësimi i sjelljes për qëllime transferimi përfshin periudhën e fundit 6 mujore që ka kaluar nga vlerësimi i mëparshëm.

Neni 86

Rregullat e sjelljes

1. Të miturit/rinjte gjatë gjithë kohës së rehabilitimit duhet të respektojnë rregullat dhe detyrimet që parashikohen në legjislacionin në fuqi dhe në programin e trajtimit të tyre. Ata duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në institucion, duke u sjellë me korrektësi dhe përgjegjshmëri ndaj punonjësve dhe njëri-tjetrit.
2. Të miturit/rinjte janë të detyruar të zbatojnë me vetëdije dhe në kohë të gjitha detyrat që u jepen nga punonjësit e institucionit, sipas rregullores së brendshme.
3. Në rast se një punonjës i institucionit konstatohet se ka ndodhur një shkelje e rregullave, rendit ose qetësisë nga ana e të miturit/riut, ai harton një raport incidenti. Ky raport duhet të përmbajë në mënyrë të hollësishme faktet, rrethanat dhe të përshkruajë qartë sjelljen e të miturit/riut që është përgjegjës për shkeljen.

Neni 87

Sjellja në raport me punonjësit e institucionit

1. Të miturit/rinjtë duhet të tregojnë sjellje të respektueshme dhe të sjellshme ndaj punonjësve të institucionit, duke mbajtur gjithmonë një komunikim me respekt të dyanshëm.
2. Kur një punonjës i institucionit hyn në dhomën ku ndodhen të miturit/rinjtë, këta të fundit duhet të mbajnë qëndrim të përshtatshëm dhe të sillen në mënyrë të disiplinuar.
3. Në rast se punonjësi hyn në ambientin ku kryhet puna e të miturve/rinjve, puna dhe aktivitetet nuk duhet të ndërpriten dhe duhet të vazhdojnë në mënyrë normale, pa u penguar nga prania e tij.

Neni 88

Sjellja e të miturve/rinjve në raport me njëri-tjetrin

1. Të miturit/rinjtë duhet të tregojnë tolerancë dhe respekt reciprok në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Ata duhet të shmangin çdo akt dhune, grindje, fyerje apo mungesë të mirësjelljes që mund të shkaktojë tension apo konflikte brenda institucionit.
2. Në rast se një i mitur/riu ndjen se është fyer apo ofenduar nga një tjetër, nuk duhet të kërkojë shlyerje personalisht apo të përgjigjet në mënyrë konfliktuale, por është i detyruar të raportojë menjëherë incidentin tek punonjësi më i afërt i institucionit për ndërhyrje dhe zgjidhje të situatës.
3. I mituri/riu është i ndaluar të kryejë çdo formë tregtie me punonjësit e institucionit apo me të miturit e tjerë brenda institucionit. Ky ndalim përfshin blerjen, shitjen, shkëmbimin, dhënien, pranimin si dhuratë, huazimin apo çdo mënyrë tjetër të transferimit të sendeve midis personave të përfshirë.

Neni 89

Sjellja e të miturve/rinjve në institucion

1. Gjatë kontrollit të prezencës, rreshtimit për lëvizje, kthimit nga vendi i punës, aktiviteteve, shërbimit të ushqimit apo situatave të ngjashme, të miturit/rinjtë janë të detyruar të ndjekin me përpikëri procedurat dhe rregullat përkatëse të përcaktuara nga institucioni.
2. Prona e institucionit duhet trajtuar me kujdes maksimal dhe nuk duhet të ndryshojë destinacion apo vendndodhje pa marrë lejen e autoriteteve kompetente. Çdo dëmtim apo abuzim me pronën e institucionit duhet të raportohen menjëherë tek punonjësi më i afërt në detyrë. Të miturit/rinjtë që shkaktojnë dëme materiale ndaj pronës së institucionit ose ndaj pronës së të miturve/rinjve të tjerë janë të detyruar ta dëmshpërblejnë atë sipas kushteve dhe procedurave në fuqi.
3. Në mënyrë të veçantë është e ndaluar:
 - a) Krijimi i zhurmave të papërshtatshme dhe shqetësuese, si thirrjet, këndimi me zë të lartë, fishkëllimat apo goditjet që prishin qetësinë.
 - b) Përdorimi i paautorizuar ose i papërshtatshëm i pajisjeve elektrike, përfshirë radiot, televizorët apo pajisje të tjera elektronike.
 - c) Hedhja apo zbrazja e sendeve nga ambientet e institucionit.
 - d) Përdorimi i papërshtatshëm i objekteve dhe inventarit të dhomës apo ambienteve të tjera.
 - e) Shkaktimi i ndotjes apo dëmtimeve në pajisjet e dhomës, mureve, dyshemesë, korridoreve apo tavanit, përfshirë edhe shkarravitjen apo dëmtimin e tyre.
 - f) Ngulja apo ngjitja e fotografive, vizatimeve apo çdo lloj mbishkrimi në pajisjet dhe muret e dhomës, përjashtuar rastet kur kjo lejohet në vendet e caktuara për këtë qëllim. Kjo është e ndaluar kategorikisht në muret e jashtme.

- g) Mbulimi i dritareve të dhomës, dyerve, dritares së kontrollit apo mureve të jashtme në mënyrë që të pengohet fusha e pamjes, përveç rasteve të lejuara nga autoritetet për arsye të veçanta.
- h) Thirrja e punonjësve të institucionit duhet të bëhet vetëm në rast emergjencash apo për arsye që kërkojnë veprim të menjëhershëm.
- i) Dyert e dhomave apo ambienteve të përbashkëta duhet të mbeten të mbyllura si rregull i përgjithshëm, përveç rasteve kur titullari i institucionit në bashkëpunim me stafin multidisiplinor vendos ndryshe, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të miturve/rinjve.
- j) Të miturit/rinjë duhet të shmangin çdo lloj shqetësimi apo zhurme gjatë orëve të pushimit të natës.
- k) Objektet personale të të miturve/rinjve që lejohen pas pranimit në institucion, apo ato që merren më vonë, duhet të ruhen në mënyrë të sigurtë dhe që nuk cenon rregullin dhe sigurinë në institucion.

Neni 90

Vlerësimi i rrezikshmërisë

1. Komisioni i rrezikshmërisë krijohet dhe funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Komisioni paraqet raportin e vlerësimit të rrezikshmërisë mbështetur në raportin e vlerësimit të riskut të sigurisë, të hartuar nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, ku i dënuari kryen dënimin.
3. Raporti protokollohet dhe një kopje e tij administrohet në dosjen personale të të dënuarit.
4. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos për ndryshimin e klasifikimit të sigurisë së të dënuarit dhe kalimin e tij nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një institucion të sigurisë së ulët dhe anasjelltas.
5. Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve vendos për kalimin e të dënuarit nga një institucion i sigurisë së ulët në një institucion të hapur dhe anasjelltas.

Neni 91

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Në rastin e dëmtimit të një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, pronë e institucionit, duhet të përcaktohet dëmtuesi dhe masa e dëmit dhe pasi dëgjohet i mituri/riu përgjegjës, njoftohet për vlerën e dëmit, duke e ftuar që ta shlyejë atë vullnetarisht. Në rast të kundërt, Drejtori i Institucionit ngre komisionin e vlerësimit të dëmit dhe urdhëron mbajtjen e vlerës monetare nga numri i llogarisë personale të të miturit/riut. Nëse vlera nuk gjendet në llogarinë personale, atëherë thirren familjarët e të miturit/të riut për të bërë zhdëmtimin kundrejt dokumentacionit ligjor.
2. Në rast dëmtimi të sendeve të të miturve/rinjve nga njëri- tjetri, Drejtori i institucionit ndërmjetëson për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes. Dëmshpërblimi vullnetar përbën rrethanë lehtësuese kur gjatë shqyrtimit të masës disiplinore, vendoset për masën disiplinore përkatëse. Në rast të kundërt, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 92

Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

1. Shkeljet disiplinore ndaj të miturve/rinjve klasifikohen në tri kategori kryesore:
 - Shkelje të lehta;
 - Shkelje të rënda;
 - Shkelje shumë të rënda.
2. **Shkelje të lehta disiplinore** konsiderohen:
 - a) Neglizhenca në kryerjen e pastrimit personal, të dhomës apo të mjediseve të përbashkëta;
 - b) Simulimi i sëmundjes pa arsye të bazuar.
3. **Shkelje të rënda disiplinore** konsiderohen:
 - a) Përdorimi i fjalëve të pahijshme ose fyese ndaj të miturve/rinjve të tjerë apo ndaj personelit të institucionit;
 - b) Kryerja e veprimeve ose akteve me qëllime përfitimi personal;
 - c) Moszbatimi i detyrimeve dhe urdhrave të dhëna, ose vonimi i pajustificuar i zbatimit të tyre.
4. **Shkelje shumë të rënda disiplinore** konsiderohen:
 - a) Organizimi, pjesëmarrja ose nxitja e veprimtarive që çenojnë masat e sigurisë në IEVP;
 - b) Kundërshtimi me dhunë ndaj punonjësve të IEVP-së;
 - c) Ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të miturve/rinjve të tjerë;
 - d) Përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga IEVP-ja, përfshirë edhe gjatë shoqërimit;
 - e) Përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së IEVP-së ose të miturve/rinjve të tjerë;
 - f) Dhuna verbale dhe sjellja agresive ndaj të miturve/rinjve të tjerë;
 - g) Mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur kjo nuk përbën vepër penale;
 - h) Përdorimi i lëndëve narkotike dhe i pijeve alkoolike;
 - i) Shkelja e afatit të kthimit në institucion pas lejes, pa arsye objektive të vërtetuara.
5. Nuk mund të fillojë procedimi disiplinor në rastet kur sjelljet, veprimet apo mosveprimet e të miturit/riut nuk përbëjnë shkelje disiplinore.
6. Masa disiplinore caktohet duke u bazuar në llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të miturit/riut gjatë procedurës, si dhe në vlerësimin e përgjithshëm të sjelljes së tij.
7. Masat disiplinore zbatohen duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të miturit/riut, duke shmangur çdo trajtim që mund të dëmtojë integritetin e tyre.
8. Masat disiplinore përdoren si mjet i fundit, pas përpjekjeve për zgjidhje alternative të konflikteve, përfshirë ndërmjetësimin mes të miturve/rinjve ose mes tyre dhe personelit të institucionit.
9. Qëllimi i masave disiplinore është të nxisin tek i mituri/riu ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë për vetëkontroll në sjellje.
10. Për personat e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, apo ata që kanë përjetuar dhunë fizike, psikologjike ose abuzim seksual, zbatohet një regjim disiplinor më lehtësues, në përputhje me nevojat e tyre specifike dhe në mbrojtje të mirëqenies së tyre psikofizike.

Neni 93

Masat parandaluese

1. Masat parandaluese jepen nga Komisioni Disiplinor i ngritur në institucion me urdhër të Drejtorit të IEVP.

2. Drejtori i Institucionit mund të urdhërojë veçimin e të miturit/riut vetëm për shkelje shumë të rënda, duke e vendosur atë në mjediset e veçimit deri në mbledhjen e Komisionit Disiplinor të institucionit.
3. Komisioni Disiplinor vendos për masën disiplinore me qëllim garantimin e sigurisë në institucion dhe parandalimin e dëmtimeve apo pasoja të mundshme që mund të shkaktohen nga sjellja apo veprimet e të miturit/riut. Po ashtu, masa synon të demonstrojë zbatimin e rregullave dhe regjimit të brendshëm të institucionit.
4. Në rast se shoqërimi i të miturit/riut në dhomat e veçimit bëhet duke përdorur forcë, personeli është i detyruar të raportojë menjëherë këtë veprim tek drejtori i institucionit, duke plotësuar formularin standard përkatës, dhe të sigurojë mbikëqyrjen e vazhdueshme të të riut.
5. Për shkelje të rënda apo të lehta, masa disiplinore ekzekutohet vetëm pas vendimit zyrtar të Komisionit Disiplinor.

Neni 94

Masat edukative për të miturit dhe të rinjtë

1. Rastet e zbatimit të masave edukative:

- a) Refuzimi për t'u zgjuar në orarin e përcaktuar;
- b) Neglizhenca në pastrimin personal dhe mirëmbajtjen e dhomës dhe ambienteve të përbashkëta;
- c) Refuzimi për të ndjekur mësimin ose për të marrë pjesë në një aktivitet të planifikuar;
- d) Prishja e rendit gjatë mësimit ose aktiviteteve të tjera;
- e) Simulimi i sëmundjes;
- f) Shkruajtja ose gërvishtja e mureve, dëmtimi i pajisjeve ndriçuese, apo lëvizja e krevatit pa leje.

2. Llojet e masave edukative dhe kohëzgjatja:

- a) Pushim/përrjashtim (time-out), deri në 30 minuta, në varësi të reflektimit të të miturit/riut;
- b) Përrjashtim nga pjesëmarrja në një prej aktiviteteve të dëshiruara gjatë ditës;
- c) Përrjashtim nga aktivitetet ditore në grup dhe qëndrim në dhomë deri në 12 orë;
- d) Përrjashtim nga përfitime shpërblyese për sjellje, si: takim i zgjatur, takime shtesë, thirrje online shtesë, etj.

3. Vendimmarrja për masat edukative:

- Masat në pikat (a) dhe (b) jepen nga Specialisti i Sektorit të Çështjeve Shoqërore (prezent gjatë aktivitetit);
- Masat në pikat (c) dhe (d) vendosen nga Drejtori i Institucionit, në varësi të sjelljes dhe përsëritjes së shkeljes.

Neni 95

Masat disiplinore për të miturit dhe të rinjtë

1. Për shkeljet disiplinore të kryera nga të miturit dhe të rinjtë zbatohen këto masa:
 - a) Këshillim individual;
 - b) Përrjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;
 - c) Përrjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;

- d) Përfundim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë.
2. Për shkeljet disiplinore shumë të rënda zbatohen këto masa:
 - a) Përfundimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë.
3. Për shkeljet disiplinore të rënda zbatohen këto masa:
 - a) Përfundim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;
 - b) Përfundim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 10 ditë.
4. Për shkeljet disiplinore të lehta zbatohen këto masa:
 - a) Këshillim individual.
 - b) Kufizim deri në 10 ditë në përdorimin e sendeve të lejuara (përfunduar ushqimet, materialet mësimore dhe barnat e përshkruara nga mjeku);
5. Ndalohet dhënia e dënimit dy herë për të njëjtën shkelje, për të cilën është dhënë vendim më parë nga organi kompetent disiplinor.
6. I mituri/riu ndaj të cilit është dhënë një masë disiplinore në përputhje me shkronjat “b” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, vendoset në dhomat e veçimit, të cilat duhet të përmbushin standardet minimale që zbatohen për qëndrimin e të dënuarve, deri në përfundim të kohëzgjatjes së masës disiplinore.
7. Masat disiplinore të përfundimit nga veprimtaritë e përbashkëta të parashikuara në shkronjat “b” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni nuk mund të fillojnë të zbatohen pa pasur raport paraprak mjekësor që vërteton gjendjen fizike dhe mendore të të miturit/riut.
8. Zbatimi i masës disiplinore të përfundimit nga veprimtaritë e përbashkëta i nënshtrohet kontrollit të përditshëm mjekësor. Regjimi gjatë zbatimit të kësaj mase disiplinore duhet të garantojë të paktën një herë kontakte me anëtarët e familjes gjatë periudhës së zbatimit, si dhe të paktën dy orë ajrim çdo ditë, nëse kushtet atmosferike e lejojnë.
9. Masat disiplinore administrohen në dosjen personale të të dënuarit dhe shërbejnë si referencë gjatë vlerësimit periodik ose me objekt, gjithnjë brenda afatit të parashkrimit.
10. Masa disiplinore parashkruhet sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.

Neni 96

Procedura e dhënies së masave disiplinore

1. Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar të miturin/riun ndaj të cilit po zhvillohet procedura disiplinore.
2. Njoftimi i të miturit/riut, ose refuzimi i tij për t'u shprehur para komisionit, vërtetohet me nënshkrimin e tij; në rastet kur ai refuzon të firmosë, vërtetimi bëhet me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli, të cilët nuk janë të përfshirë në ngjarjen.
3. I riu mund të mbrohet vetë ose nga mbrojtësi i tij, kur e çmon të nevojshme. Gjithashtu, atij i garantohet e drejta për të thirrur dëshmitarë në emër të tij, për të kundërshtuar provat ndaj tij, si dhe i sigurohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen. Në rast pamundësie për të kontraktuar mbrojtës ligjor (avokat), kjo e drejtë realizohet nëpërmjet bashkëpunimit të institucionit me zyrën juridike falas.
4. I mituri ka të drejtë për të pasur një mbrojtës në seancën dëgjimore të shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Përpara se të fillojë seanca dëgjimore, i mituri informohet për të drejtën për të pasur një mbrojtës, gjë që ushtrohet brenda gjashtë orëve nga dhënia e informacionit, në rast se ka një

pëlqim të lidhur me të. Në rast se mbrojtësi nuk paraqitet në kohën e përcaktuar, të miturit do t'i caktohet një mbrojtës kryesisht. I mituri jep pëlqimin lidhur me mbrojtësin kryesisht.

5. Të miturit/rinjtë me shtetësi të huaj kanë të drejtë të kenë përkthyes nëse nuk kuptojnë ose nuk flasin gjuhën shqipe.
6. Komisioni disiplinor i dorëzon të riut me një kopje të vendimit për marrjen e masës disiplinore.
7. Masa disiplinore nuk mund të jepet nëse kanë kaluar më shumë se 30 ditë nga data e konstatimit të shkeljes disiplinore.

Neni 97

Ankimimi kundër vendimit të komisionit disiplinor

1. I riu ka të drejtë të ankimojë masën disiplinore pranë Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (D.P.B.), brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur është vënë në dijeni për vendimin.
2. Komisioni i Apelimit vendos brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga marrja e ankimit, duke zgjedhur të lërë në fuqi, të shfuqizojë ose të kthejë për rishqyrtim vendimin e Komisionit Disiplinor të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP).

KAPITULLI XIII

LEJET SHPËRBLYESE DHE TË VEÇANTA

Neni 98

Shqyrtimi i kërkesave për leje shpërblyese dhe të veçanta

1. Drejtori i Institucionit është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për leje shpërblyese dhe leje të veçanta, për të dënuarit e sistemuar në regjim sigurie të zakonshme.
2. Sektori Ligjor, në fillim të çdo viti kalendarik, harton dhe dërgon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve planifikimin paraprak vjetor të lejeve shpërblyese për të dënuarit që plotësojnë kriteret ligjore, sipas një grafiku të strukturuar.
3. Kërkesat për leje shpërblyese ose të veçanta i drejtohen me shkrim Drejtorit të Institucionit dhe regjistrohen në Regjistrin e Lejeve të të Dënuarve, në përputhje me formatin dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore.

Neni 99

Lejet shpërblyese

1. Të dënuarit e moshës 18–21 vjeç, të cilët:
 - respektojnë rregulloren dhe disiplinën e institucionit;
 - janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese dhe të ri-integrit;
 - dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore
 - të rinjtë që e përfitojnë lejen shpërblyese;

kanë të drejtë të përfitojnë leje shpërblyese në një kohëzgjatje deri në 20 ditë në vit, të ndara në faza tremujore

Planifikimi i lejeve shpërblyese bëhet sipas një grafiku të miratuar në fillim të vitit, ku përfshihen të dënuarit e të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

2. Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje shpërblyese, Drejtori i Institucionit vendos për miratimin ose refuzimin e saj, bazuar në:
 - planifikimin vjetor;
 - raportet e vlerësimit nga sektori i policisë, sektori i çështjeve shoqërore dhe sektori ligjor.
3. Raportet e vlerësimit përfshijnë:
 - respektimin e kërkesave ligjore;
 - vlerësimin e sjelljes së të dënuarit;
 - vlerësimin e riskut;
 - pjesëmarrjen në programe rehabilituese dhe ri-integrimi;
 - pjesëmarrjen në programe të tjera institucionale;
 - besueshmërinë për kthim në institucion pas përfundimit të lejes;
 - ekzistencën ose mungesën e masave disiplinore;
 - marrëdhëniet me familjen;
 - çdo aspekt tjetër që lidhet me profilin e të dënuarit.

Dhënia e lejes shpërblyese kërkon vlerësim pozitiv nga të gjithë sektorët përkatës.

1. Leja shpërblyese u jepet:
 - a) Të dënuarve me dënim deri në 3 vjet, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit
 - b) Të dënuarve me dënim nga 3 deri në 10 vjet, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;
 - c) Të dënuarve me dënim mbi 10 vjet, kur u kanë mbetur më pak se 5 vjet dënim për të vuajtur.
 2. Në çdo rast, ndërmjet dy lejeve shpërblyese duhet të kenë kaluar jo më pak se 3 muaj nga miratimi i lejes së mëparshme.
 3. Të dënuarit që dënohen për një vepër penale të kryer gjatë vuajtjes së dënimit, nuk përfitojnë leje shpërblyese.
 4. Për të dënuarit me vendim bashkimi dënimesh, përlllogaritja e afatit për të përfituar leje shpërblyese i referohet masës së dënimit të bashkuar, sipas përcaktimeve të pikës 5 të këtij neni.
 5. Në rast refuzimi të lejes shpërblyese:
 - Për të dënuarit në seksionin e sigurisë së zakonshme ose të ulët, përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të ankohet brenda 5 ditëve pranë Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Pas kësaj, i dënuari ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, e cila shqyrton kërkesën për leje.
- Procedurat për dhënien e lejeve shpërblyese përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 100

Lejet e veçanta

1. Autoriteti përgjegjës

Prokurori dhe Drejtori i Institucionit është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin dhe

vendimmarrjen mbi kërkesat për leje të veçantë të paraqitura nga i mituri/riu, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

- a) Kërkesa duhet të jetë e argumentuar me shkrim dhe e shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues.
- Në rastet e sëmundjeve të rënda, që rrezikojnë jetën e një anëtari të familjes, kërkesa shoqërohet me raportin mjekësor të personit të sëmurë, ku vërtetohet gjendja e rëndë shëndetësore.
- Në rastet e ngjarjeve të rëndësishme familjare si vdekje, lindje, martesë, kërkesa shoqërohet me dokumentin përkatës (certifikatë vdekjeje, lindjeje, martese). Leje e veçantë mund të kërkohej edhe për dhënien e provimeve.
- Me “anëtar të familjes” nënkuptohen: prindërit, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat.
- b) Pas marrjes së kërkesës, brenda ditës, Drejtori i Institucionit urdhëron:
 - Përgjegjësën e Sektorit Ligjor;
 - Shefin e Policisë;
 - Përgjegjësën e Sektorit të Çështjeve Shoqërore;

për të shqyrtuar dokumentacionin dhe për të përgatitur raportin e përbashkët të vlerësimit, që do të shërbejë si bazë për vendimmarrje.
- c) Në rastet kur leja e kërkuar lidhet me sëmundje të rëndë të një anëtari të familjes, dokumenti mjekësor:
 - vlerësohet nga Përgjegjësi i Sektorit të Shëndetësisë në institucion, ose në mungesë të tij, nga mjeku i institucionit;
 - mjeku harton një akt verifikimi mbi epikrizën mjekësore, ku:
 - kontrollon elementët që vërtetojnë saktësinë e raportit;
 - verifikon situatën përmes komunikimit me spitalin përkatës ose mjekët përgjegjës;
 - jep mendim të arsyetuar me shkrim mbi shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes.

Ky akt bashkëlidhet me raportin përfundimtar të tre sektorëve.
- d) Shefi i Policisë dhe Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve Shoqërore përgatisin brenda ditës një raport të përbashkët të hollësishëm, i cili përfshin:
 - lidhjen familjare me personin e sëmurë apo të ndjerin;
 - kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit;
 - historikun e lejeve të mëparshme;
 - respektimin e rregullores së institucionit;
 - rrezikshmërinë dhe besueshmërinë për kthim pas lejes;
 - pjesëmarrjen në programe rehabilituese;
 - të dhëna të tjera të rëndësishme për profilin e të miturit/riut;
 - si dhe një propozim të arsyetuar për miratim ose refuzim të lejes, duke sugjeruar edhe kohëzgjatjen e saj.
- e) Raporti, dokumentacioni dhe propozimi i paraqiten Drejtorit të Institucionit brenda së njëjtës ditë, i cili vendos miratimin ose refuzimin e kërkesës, në mënyrë të argumentuar me shkrim.
- f) Leja e veçantë mund të miratohet vetëm nëse ekziston mendim pozitiv i të tre sektorëve (Ligjor, Polici, Çështje Shoqërore), në favor të dhënies së saj.

2. Kushtet e shoqërimit dhe zgjatja e lejes

Drejtori i institucionit, në vendimin për miratimin e lejes, përcakton:

- mënyrën dhe kushtet e shoqërimit,
 - mjetet dhe numrin e forcave të Policisë së Burgjeve që do të angazhohen.
- Leja e veçantë jepet vetëm gjatë ditës, për një kohëzgjatje deri në 48 orë, me shoqërim të detyrueshëm.
 - Leja e veçantë mund të zgjatet edhe me 24 orë të tjera, vetëm në rastet e sëmundjeve të rënda, me miratimin e Drejtorit të institucionit dhe kundrejt paraqitjes së dokumentacionit përkatës shtesë.
 - Leje e veçantë pa shoqërim mund të miratohet vetëm për të dënuarit që kanë përfutur më parë leje shpërblyese, dhe vetëm nëse paraqesin rrezikshmëri të ulët dhe besueshmëri të provuar.
 - Për të paraburgosurit e mitur/ të rinj, lejet e veçanta jepen në përputhje me këtë nen, por vetëm me miratim të prokurorit dhe me shoqërim të detyrueshëm nga Policia e Burgjeve.

Neni 101

Përrjashtimet nga lejet e veçanta për të miturit dhe të rinjtë e paraburgosur

1. Të miturit/rinjtë që ndodhen në paraburgim nuk përfitojnë leje shpërblyese, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve (2025).
2. Përrjashtimisht, me miratimin paraprak të Prokurorit kompetent dhe Drejtorit të Institucionit, të miturve/rinjve në paraburgim mund t'u jepet leje e veçantë, me shoqërim të detyrueshëm, në këto raste:
 - a) Martesa e një anëtari të ngushtë të familjes, si: vëllai, motra ose prindi i të miturit/riut;
 - b) Vdekja e gjyshërve, vëllait, motrës apo prindit të të miturit/riut;Sëmundje të rëndë që rrezikon jetën e një anëtari të familjes, e vërtetuar përmes raportit mjekësor zyrtar;
Pjesëmarrja në provime të parashikuara zyrtarisht, nga vetë i mituri/riu.
3. Verifikimi dhe dokumentimi
Faktet juridike dhe identiteti i personave për të cilët kërkohet leja e veçantë verifikohen dhe dokumentohen përmes akteve zyrtare të lëshuara nga institucionet përkatëse (Gjendja Civile, Spitali, Universiteti, etj.).

Neni 102

Leja shpërblyese për të miturin e dënuar me burgim

Për të miturit e dënuar, koha totale e lejeve shpërblyese përcaktohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

1. E drejta për leje të shkurtër

I mituri i dënuar me burgim ka të drejtë të përfitojë deri në tre leje të shkurtra në vit.

Kohëzgjatja e kësaj leje nuk i kalon 15 ditë. Në këtë kohëpërfshihet edhe kohën e nevojshme për udhëtimin nga dhe drejt vendit të vuajtjes së dënimit.

2. Kushtet për përfitimin e lejes

I mituri i dënuar përfiton leje të shkurtër, nëse plotëson këto kritere në lidhje me kohën e vuajtjes së dënimit:

- a) Ka kryer jo më pak se një të tretën ($1/3$) e dënimit, nëse është dënuar me burgim deri në 3 (tre) vjet;
- b) Ka kryer jo më pak se gjysmën ($1/2$) e dënimit, nëse është dënuar me burgim deri në 8 (tetë) vjet;
- c) Ka kryer jo më pak se dy të tretat ($2/3$) e dënimit, nëse është dënuar me burgim mbi 8 (tetë) vjet.

Neni 103

Lirimi me kusht

1. I mituri i dënuar mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm nëse ka kryer:
 - a) Jo më pak se një të tretën ($1/3$) e dënimit me burgim, nëse është dënuar me burgim deri në 3 vjet;
 - b) Jo më pak se një të dytën ($1/2$) e dënimit me burgim, nëse është dënuar me burgim deri në 8 vjet;
 - c) Jo më pak se dy të tretat ($2/3$) e dënimit me burgim, nëse është dënuar me burgim mbi 8 vjet.
2. Afati i kryer i burgimit nuk duhet të jetë më pak se tre muaj.
3. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturit, jo më vonë se tre muaj para datës më të afërt të lirimit me kusht, njofton Shërbimin e Provës mbi mundësinë e lirimit të të miturit. Shërbimi i Provës analizon sjelljen gjatë vuajtjes së dënimit, të dhënat kriminale, personalitetin, kushtet familjare, natyrën e veprës penale dhe rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vendimin për lirimin me kusht.
4. Koha e kryer në formën e punës në shërbim të publikut përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit sipas përlllogaritjes: 10 orë punë në shërbim të publikut barazojnë një ditë burgim.
5. Koha e kryer në formën e dënimit me kufizim të lirisë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit sipas përlllogaritjes: një ditë kufizim të lirisë barazon një ditë burg.
6. Në rast refuzimi të lirimit me kusht, gjykata duhet të përcaktojë masat që duhet të ndërmerren nga i mituri dhe nga administrata e institucionit, për të përmbushur kushtet e lirimit me kusht në të ardhmen.

Neni 104

Transferimi në një tjetër institucion të ekzekutimit të vendimit pas mbushjes së moshës 21 (njëzet e një) vjeç

1. I paraburgosuri ose i dënuari që mbush moshën 21 vjeç nuk lejohet të qëndrojë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë, dhe dërgohet në institucionin për të rriturit.
2. Vendi i vuajtjes së dënimit për të riun e dënuar që ka mbushur moshën 21 vjeç përcaktohet si më poshtë:

- a) Institucioni i hapur, kur i ka mbetur më pak se 6 (gjashtë) muaj burgim;
 - b) Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale me siguri të ulët, kur i ka mbetur deri në 5 (pesë) vjet burgim;
 - c) Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale me siguri të zakonshme, për të gjitha rastet e tjera.
3. Një (1) muaj para mbushjes së moshës 21 vjeç, drejtori i institucionit ku ndodhet i mitur/riu i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve të përcaktojë institucionin për të rritur ku do të vuajë dënimin i riu.
 4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve merr vendimin për vendin e vuajtjes së dënimit apo institucionin e paraburgimit të paktën dhjetë (10) ditë para datës së mbushjes së moshës 21 vjeç nga ana e të miturit.
 5. Ditën kur i riu mbush moshën 21 vjeç, bëhet transferimi i tij në institucionin e përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, sipas urdhërit të tij.
 6. I riu i transferuar pas mbushjes së moshës 21 vjeç trajtohet nga personeli i kujdesit psikosocial, me qëllim sigurimin e vijimësisë së programeve rehabilituese dhe të integritetit të zbatuara në institucionet për të rritur.

Neni 105

Transferimi i përkohshëm i të miturit në një vend tjetër

I mituri i arrestuar/i dënuar mund të transferohet përkohësisht në një vend tjetër për të mitur në qoftë se një masë e tillë është e domosdoshme për sigurinë e tij ose për sigurinë e të miturve të tjerë. Në këtë rast, rregullat mbi transferimin parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

2. Menjëherë pas transferimit të të miturit në një vend tjetër:

- a) informohet përfaqësuesi ligjor për vendndodhjen e të miturit;
- b) i mituri i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor;
- c) i mituri ka të drejtën e një telefonate jo më shumë se 15 minuta.

KAPITULLI XIV

TRAJTIMI I KATEGORIVE TË TJERA

Neni 106

Trajtimi i të miturve/rinjve me shtetësi të huaj

1. Të miturit/rinj të me shtetësi të huaj kanë të drejtë të njoftojnë familjen, përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin konsullor, ose organizatat kompetente që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
2. Për të miturit/rinj të shtetas të huaj që nuk disponojnë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, si dhe për personat pa shtetësi, u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre, ose me autoritetet kombëtare ose ndërkombëtare që janë përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Neni 107

Procedurat për trajtimin e trupit dhe organizimin e ceremonive për të miturit/rinj të ndarë nga jeta

1. Trupi i të miturit/riut të huaj i ndarë nga jeta mbahet në institucionin përkatës deri në koordinimin me përfaqësitë diplomatike, konsullore ose autoritetet kompetente përkatëse të shtetit të tij, për organizimin e procedurave të nevojshme për transferimin ose varrimin e tij.
2. Në rast se familjarët e të miturit/riut nuk mund të përballojnë shpenzimet për organizimin e varrimit, autoritetet shqiptare mund të ndërmarrin masat për kryerjen e ceremonisë në përputhje me ligjin dhe praktikat ndërkombëtare, duke informuar përfaqësitë e shtetit përkatës.
3. Të gjitha veprimet lidhur me trajtimin e trupit, dokumentacionin dhe komunikimet përkatëse duhet të bëhen në respekt të dinjitetit dhe normave ndërkombëtare për trajtimin e personave të ndarë nga jeta.

Neni 108

Trajtimi i të miturve/rinjve të minoriteteve etnike ose gjuhësore

Të miturit/rinj të që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaja ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që ata kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion, si dhe nëse është e mundur ju ofrohen kurse të gjuhës shqipe.

Neni 109

Trajtimi i të miturve/rinjve me aftësi të kufizuara

1. Të miturve/rinjve me aftësi të kufizuara u ofrohet trajtim dhe sigurim shëndetësor, në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.
2. Shërbimi shëndetësor i të miturve/rinjve me aftësi të kufizuara u ofrohet me të njëjtën cilësi dhe standard të shërbimeve shëndetësore në strukturat e shëndetit publik dhe pa pagesë.
3. Institucioni siguron kushte të përshtatshme fizike dhe mjedisore për lëvizjen, mbrojtjen dhe trajtimin e të miturve/rinjve me aftësi të kufizuara.
4. Për çdo të mitur/ri me aftësi të kufizuara hartohet një plan individual trajtimi dhe mbështetjeje, në bashkëpunim me personelin mjekësor, psikologjik dhe social.
5. Personeli i institucionit trajnohet për të kuptuar dhe menaxhuar nevojat specifike të të miturve/rinjve me aftësi të kufizuara.

Neni 110

Trajtimi i të miturve/rinjve me HIV/AIDS

1. Për të miturit/rinj të me HIV/AIDS garantohet trajtim specifik falas dhe ofrohet këshillim për HIV/AIDS-in, me qëllim përgatitjen e të dënuarit për përballimin e pasojave të mundshme të stresit dhe për t'i ndihmuar në marrjen e vendimeve bazuar në informacionet për HIV/AIDS-in.
2. Këshillimi përfshin informimin, edukimin dhe mbështetjen psiko-sociale, të cilat i mundësojnë personit me HIV/AIDS të jetojë dhe parandalojë transmetimin e virusit HIV/AIDS.
3. Informacioni mbi statusin HIV/AIDS trajtohet me konfidencialitet maksimal, duke ruajtur privatësinë dhe dinjitetin e të miturit/riut.

4. Personeli i institucionit trajnohet për të menaxhuar në mënyrë adekuate nevojat e të miturve/rinjve me HIV/AIDS dhe për të parandaluar diskriminimin apo stigmatizimin e tyre.

Neni 111

Dhënia e informacionit medias dhe publikut

1. Institucioni siguron akses të kontrolluar dhe të drejtë për media dhe publik, duke i vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, përveç rasteve kur ky informacion përmban të dhëna që cenojnë të drejtën për jetë private, të dhëna sensitive, apo çdo informacion tjetër që mund të rrezikojë sigurinë e institucionit, sigurinë personale të të miturit/riut, ose proceset hetimore dhe gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Njësia përgjegjëse (përcaktuar nga Titullari) për dhënien e informacionit përpunon dhe administron kërkesat për informacion nga palët e treta në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar konfidencialitetin dhe dinjitetin e të miturit/ri.
3. Kur informacioni kërkohet nga një person ose organ i tretë, përfshirë mediat, aplikohen procedurat e përcaktuara në ligjin për të drejtën e informimit, duke respektuar kufizimet ligjore për mbrojtjen e të miturve/rinjve dhe sigurinë institucionale.
4. Çdo dhënie informacioni duhet të aprovohet nga drejtori i institucionit ose nga personi i autorizuar nga ai, duke siguruar që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i përshtatshëm dhe i pajtueshëm me legjislacionin në fuqi, duke mos cënuar sigurinë e të mitur/rinjt.

KAPITULLI XV

NJOFTIM PËR VDEKJET, SËMUNDJET E TË MITURVE/RINJVE

Neni 112

Njoftimet për rastet e sëmundjeve dhe vdekjeve

1. Në rastet e sëmundjeve të rënda apo dëmtimeve serioze të të miturit/riut, institucioni është i detyruar të njoftojë menjëherë familjarët, të afërmit, ose çdo person tjetër që i mituri/riu ka caktuar paraprakisht.
2. I mituri/riu duhet të njoftohet menjëherë për vdekjen ose sëmundjen serioze të familjarëve ose të afërmeve të tij.
3. Për vdekjen e të burgosurit me shtetësi të huaj ose i mitur/ri pa shtetësi dhe për vendosjen e tij në varrezat publike njoftohet ministria përgjegjëse për punët e jashtme.
4. Ministria e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për gjendjen civile dhe ministria përgjegjëse për punët e jashtme nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e këtij neni.

Neni 113

Veprimet në rast vdekjeje

1. Në rast vdekjeje të të miturit/riut, institucioni merr menjëherë masa për kryerjen e procedurave ligjore, që përfshijnë verifikimin e rastit, përcaktimin e shkakut të vdekjes, kryerjen e veprimeve procedurale hetimore dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm për sqarimin dhe dokumentimin e faktit të vdekjes.

2. Institucioni njofton pa vonesë Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Prokurorinë, familjarët e të ndjerit dhe, në rast mungese të familjarëve, autoritetet e gjendjes civile.
3. Sendet personale dhe depozitat në para të të miturit/riut i dorëzohen familjarëve, duke respektuar procedurat dhe dokumentacionin përkatës.
4. Nëse brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e vdekjes sendet personale nuk janë tërhequr nga familjarët ose të afërmit, ato dorëzohen pranë organeve të qeverisjes vendore të vendbanimit të të ndjerit.
5. Në rast se familja ose të afërmit nuk e marrin trupin e të ndjerit, personeli i institucionit bashkëpunon me organet e pushtetit vendor për varrosjen në varrezat publike, duke përballuar shpenzimet e nevojshme dhe duke bërë shënimin e duhur në regjistrin themeltar të varrimeve.

KAPITULLI XVI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 114

Mbrojtja shtesë e të paraburgosurve

1. Në asnjë rast, të miturit/rinj nuk trajtohen si të dënuar, ose shtetas që mund të dënohen në të ardhmen.
2. Të miturit/rinj të kanë të drejtat dhe detyrimet e të dënuarve me burgim, për atë kohë sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore dhe në legjislacionin në fuqi.
3. Të miturit/rinj të kanë të drejtë të informojnë menjëherë familjen për vendndodhjen e tyre dhe u krijohen kushtet për të takuar familjarët, përjashtuar rastet kur kjo pengon hetimin ose nuk është në interes të zhvillimit të gjykimit.
4. Drejtori i institucionit mund të kufizojë të drejtën e të paraburgosurve për vizita, letërkëmbim ose biseda telefonike, kur kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale të urdhëruara nga organet kompetente.

Neni 115

Këshillimi ligjor

Të miturit/rinj të informohen në çdo rast për të drejtën e tyre për të përfituar këshillim ligjor. Për ta, krijohen procedura të lehtësuara që të mund të takojnë mbrojtësit ligjorë dhe të përgatitin mbrojtjen e tyre gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Neni 116

Ndihma juridike

1. Të miturit/rinj informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose në rast se nuk kanë mundësi financiare për të siguruar një mbrojtës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

2. Mjediset ku mbahen të miturit/rinj duhet të ofrojnë mundësinë që ata të takohen privatisht dhe të komunikojnë me mbrojtësit e tyre, si dhe të kenë kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen përgjatë gjithë procesit gjyqësor.
3. Të miturve/rinjve u garantohet ndihmë juridike dhe psikologjike, si dhe ushtrimi i të gjitha të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 117

Lirimi i të paraburgosurve

1. Lirimi i të paraburgosurit mitur/riu urdhërohet nga gjykata ose prokuroria.
2. Në rastet kur i mituri/riu i liruar nuk ka mundësi strehimi ose transporti pranë familjes së tij, drejtori i institucionit, në bashkëpunim me institucionet vendore dhe organizatat e tjera, mundëson sistemimin dhe transportin e tij.
3. Në rast pamundësie objektive të të miturit/riut për t'u larguar nga institucioni pas lirim, me kërkesën e tij, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) mundëson strehimin në institucion jashtë regjimit të brendshëm deri në përfundimin e pengesës për largim.
4. Personeli menjëherë pas lirim, të të miturit/riut apo të të dënuarit plotëson të dhënat në sistemin MISP dhe në Sistem-in e Integruar të Hidhjes së të Dhënave për të miturit/rinj në konflikt me ligjin, si dhe njofton policinë dhe prokurorinë për ekzekutimin e vendimit penal.

Neni 118

Dispozita kalimtare

Rregullorja e brendshme e IEVP Kavajë, miratuar me Urdhër Nr.5599/2 datë 18.08.2010, shfuqizohet.

Neni 119

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas datës së miratimit.